



**ShKÇAK**  
**DKRRK**  
**SCAAK**

**RAPORTI | 20**  
**VJETOR | 16**



# MISIONI

## MISIONI

Misioni ynë është që të zhvillojmë dhe avancojmë një organizatë profesionale dhe konkurruese edhe në tregun ndërkombëtar, e cila përmbush standardet më të larta profesionale dhe etike, si dhe perfeksionon performancën organizative përmes menaxhimit financiar, sigurisë dhe ekspertizës së specializuar. Ne veprojmë me integritet, objektivitet dhe me përkushtim ndaj cilësisë dhe interesit publik.

# VIZIONI

## VIZIONI

Vizioni ynë është të bëhemi prijës në krijimin, vlerësimin dhe interpretimin e informatave, të cilat masindheavancojnë performancën organizative, duke pasur për synim ofrimin e zgjedhjes sa më të mirë të menaxhimit financiar, sigurisë dhe shërbimeve tjera të specializuara.

# QËLLIMI

## QËLLIMI

Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare

## PËRMBAJTJA

Përvjetori i pesëmbëdhjetë i një historie të suksesit	06
Fjala e Kryetarit	08
Mesazh nga Drejtoresha Ekzekutive	10
Aktivitet që karakterizuan vitin 2016	12
Shoqata vazhdon me sukseset e saj - Njohje reciproke e çertifikimeve	25
Përfaqësimi i ShKÇAK në ngjarje dhe aktivitete në vend, rajon dhe botë	27
Ngritja e kapaciteteve profesionale - Shtyllë kyçe e ShKÇAK	35
Shërbimi dhe komunikimi me anëtarë - Objektivë e përhershme e Shoqatës	38
Studentët e dalluar për vitin 2016	39
Raportet nga komisionet	41
Raport nga Komisioni për Nominime	42
Raport nga Komisioni për Edukim Profesional	43
Raport nga Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë	45
Raport nga Nën-Komisioni për Tatime	46
Raport nga Komisioni për Kontroll të Cilësisë	47
Raport nga Komisioni për Standarde Profesionale	48
Struktura Organizative e ShKÇAK	49
Statistikat e Vitit 2016	50
Pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur	54

## LISTA E SHKURTESAVE

AL	Auditor i Licencuar
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BSNEK	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit dhe Kontabilitetit
BSNKSP	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
DOA	Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë
DShA	Departamenti i Shërbimit për Anëtarë
EVP	Edukimi Vazhdueshëm Profesional
FEE	Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve
CIPFA	Instituti i Licencuar për Financë Publike dhe Kontabiliteti Anglisë
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve/Auditorëve
AICPA	Instituti Amerikani Auditorëve të Çertifikuar Publik
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
NBA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Holandës
SAIPA	Instituti i Kontabilistëve Profesionalistë të Afrikës Jugut
IPKA	Instituti Publik i Kontabilistëve dhe Auditorëve
KBKA	Kongresi Botëror i Kontabilistëve dhe Auditorëve
CNDCEC	Këshilli Kombëtar Italian i Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar
KKRF	Këshilli Kosovë për Raportim Financiar
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit të Republikës së Shqipërisë
PAODC	Komisionin për Zhvillime Organizatave Profesionale të Kontabilitetit/Auditimit
MOSAIC	Marrëveshja e Mirëkuptimit për Fuqizimin e Kontabilitetit dhe Përmirësimin
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
OPK	Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit
QRRF	Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar e Bankës Botërore
REPARIS	Rruga drejt Evropës: Programi i Reformës në Kontabilitet dhe Forcimit Institucional
ROSC	Raporti për Respektimin e Standardeve dhe Kodeve
SNA	Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit
SNE	Standardet Ndërkombëtare të Edukimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ACCA	Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar të Anglisë
SHKÇAK	Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
AAT	Shoqata e Teknikëve të Kontabilitetit, Britani e Madhe
UBT	Universiteti për Biznes dhe Teknologji
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

SHKËQAK  
DKRRK  
SCAAK

SPECIALIZIMI PROFESIONAL  
DOMOSDOSHMËRI PËR ZHVILLIM EKONOMIK  
PROFESSIONAL SPECIALISATION  
ESSENTIAL FOR ECONOMIC DEVELOPMENT

Sponsoruar nga: PEJA EVE BAKK TITIK KOSOVA 80 SHARRCIN

Partësitur nga: HISTRIK EDCI MEDICAN Meridian Baku RUGEVE



15 VJET  
YEARS

## PËRVJETORI I PESËMBËDHJETË I NJË HISTORIE TË SUKSESIT

Pesëmbëdhjetë vjet më parë, kur Kosova e rrënuar nga lufta po përjetonte vitin e dytë të lirisë, një grup profesionistësh të kontabilitetit dhe auditimit, vizionarë për shtet ndërtim, shfaqti idenë për themelimin e programit të parë të edukimit për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.

Duhej shumë vullnet dhe kurajo për ta realizuar këtë ide e cila u mbështet nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës dhe nga organizata ndërkombëtare me ndikim, që vinin nga shtetet mike të Kosovës, të cilat ishin përkushtuar për zhvillimin dhe implementimin e reformave ekonomike në shtetin e ri.

Duke parë trendin global të zhvillimeve ekonomike, themeluesit e Shoqatës që në fillim kishin vendosur që e gjithë veprimtaria e saj të bazohet në standarde ndërkombëtare, me programe certifikuese të të njëjtit nivel me ato që ofroheshin nga shoqatat e njohura globalisht, vendim ky që e drejtoi Shoqatën për pesëmbëdhjetë vjet me radhë e tutje.

Sot, një dekadë e gjysmë më pas, Shoqata ka arritur të jetë shembull global për vendet në zhvillim duke qenë anëtare e përkushtuar e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (IFAC) dhe Federatës së Kontabilistëve të Mesdheut (FCM). Duke qenë pjesë e bordeve dhe komisioneve në këto organizata, ajo arriti të bartë përvojën dhe përkushtimin e saj për të ndihmuar shtetet të cilat synojnë ngritjen dhe zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në vendet e tyre.

Në kohën kur Kosova është duke kaluar në procese të përbushjes së standardeve evropiane për të qenë pjesë e saj, Shoqata në 15 vjetorin e themelimit u anëtarësua në Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve (EFAA), me çka dëshmon përbushjen e standardeve ndërkombëtare të kërkuara nga BE.

Sot, pesëmbëdhjetë vite më pas, Shoqata numëron më se 7000 anëtarë të regjistruar, gjë që dëshmon besimin dhe reputacionin që ajo ka në publikun e gjerë, interesim ky që çdo vit është në rritje e tutje.

Kjo gjë u realizua edhe duke punuar intenzivisht që anëtarët të jenë të pranuar si dhe të kenë mundësinë e lëvizjes së lirë si profesionistë edhe në shtetet euro-atlantike duke nënshkruar marrëveshje për njohje reciproke të thirrjeve të saj si në sektorin privat po ashtu edhe të atyre të sektorit publik.

Përgjegjësia e madhe që SHKÇAK ka treguar ndaj palëve me interes dhe shoqërisë, duke edukuar gjenerata të tëra profesionistësh për pesëmbëdhjetë vjet me radhë dhe duke ngritur vetëdijësimin për transparencën dhe llogaridhënien ka dëshmuar se edhe në një shtet të ri, ndërtimi i një organizate profesionale të përkushtuar për mbrojtjen e interesit publik dhe e cila ofron shërbime kualitative profesionale, është i mundshëm.

Pesëmbëdhjetë vjet pas themelimit, rrëfimi për Shoqatën përkufizohet në një histori suksesi, e cila shtetit të ri të Kosovës i ka bërë vend në nivelet më të larta ndërkombëtare të profesionin, ndërsa gjeneratave të reja u ka siguruar një edukim cilësor që ka vlerë ndërkombëtare.

Të gjitha këto të arritura janë rezultat i përkushtimit të vazhdueshëm të zyrës ekzekutive, Këshillit të Shoqatës, anëtarëve të saj dhe bashkëpunëtorëve.



15

VJET  
YEARS





## FJALA E KRYETARIT

Të nderuar anëtarë

Bota në të cilën jetojmë është duke ndryshuar me shpejtësi të madhe. Bashkë me këto ndryshime në botë është duke ndryshuar edhe profesioni i kontabilitetit.

Disa prej sfidave me të cilat ballafaqohen profesionistët sot në botë, dhe Kosova këtu nuk bën përjashtim janë: ndryshimet teknologjike, fushat e reja të ekspertizës, edukimi i vazhdueshëm dhe etika. Me siguri që kjo nuk është një listë shteruese, por unë do të merrem me këto që mendoj se prej më të rëndësishmeve.

Në fillimet e veta, softueri i kontabilitetit është konsideruar si një mjet i rëndësishëm për lehtësimin e kryerjes së detyrave të kontabilitetit. Mirëpo, tani softueri konsiderohet si pjesë përbërëse e sistemit të kontabilitetit dhe e profesionit të kontabilitetit në tërësi. Me futjen në përdorim të softuerit, me një personel të paktë në numër kryhen punë dhe detyra që më parë janë kryer nga një 'armatë' e punëtorëve të punësuar në kontabilitetin e një ndërmarrje. Megjithatë kjo ka krijuar një problem shumë të madh: me zvogëlimin e numrit të punëtorëve, pothuajse është zhdukur në tërësi struktura organizative e cila më parë ka ekzistuar dhe e cila ka mundur ndarjen adekuate të punëve dhe detyrave brenda ndërmarrjes. Më pak njerëz kryejnë më shumë detyra gjë që në fakt rrezikon kontrollin e brendshëm në ndërmarrje dhe lë të hapur mundësinë e mashtrimeve. Është e nevojshme që të krijohet një infrastrukturë adekuate teknologjike dhe e resurseve humane që do të mundësojë përdorimin koherent të teknologjisë duke pasur për bazë sistemin e kontrollit të brendshëm.

Profesioni i kontabilitetit është duke u ndryshuar me të madhe. Prej kontabilistëve kërkohet gjithnjë e më tepër njohuri më e gjerë në fusha për të cilat më parë

nuk është menduar, përfshirë fushën e vlerësimeve dhe falimentimit. Më lart u fol për teknologjinë informative. Ajo tani ka mundur që shumë punë dhe detyra, siç janë p.sh. regjistrimet e përditshme të transaksioneve, të realizohen me shpejtësi dhe saktësi të madhe. Kjo i sjell informatat te menaxhmenti në baza ditore. Megjithatë, kjo gjë ka krijuar një kërkesë të re për kontabilistët. Ata duhet të shndërrohen në analistë të përditshëm duke shpjeguar informatat dhe raportet që 'prodhohen' çdo ditë me ndihmën e teknologjisë. Pa ata duhet të jenë të përgatitur profesionalisht në fushën e kontabilitetit, por edhe të jenë në gjendje t'iu adaptohen këtyre ndryshimeve teknologjike të vazhdueshme.

Kjo edhe e sjell nevojën e edukimit të vazhdueshëm profesional. Ne jemi në gjendje të shohim ndryshime të mëdha dhe shumë të shpeshta në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Nga viti 2012, në Kosovë kërkohet zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar/SNRF, dhe tani edhe SNRF-ve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Zbatimi i tyre në praktikë ka sfida të vazhdueshme, shtu këtu edhe ndryshimet që iu bëhen atyre në vazhdimësi, si dhe standardet e reja. Prandaj, është një nevojë e vazhdueshme që profesionistët që merren me kontabilitetin t'i mirëmbajnë dhe pasurojnë njohuritë e tyre përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional. Në ndryshimet e Ligjit mbi raportimin financiar, kontabilitetin dhe auditimin, Shoqata ka propozuar rritjen e rolit të kontabilistit të certifikuar. Ne kemi kërkuar që të jetë e obligueshme që pasqyrat financiare të nënshkruhen nga ana e kontabilistit të certifikuar. Kjo do ta rrisë njëkohësisht rolin por edhe përgjegjësinë e tij për implementimin adekuat të standardeve të kontabilitetit.

Kjo gjë i krijon parakushtet për të filluar edhe programin e kontrollit të cilësisë së punës së kontabilistëve, e cila për momentin as nuk kërkohet dhe as nuk zbatohet.

Nëse një profesionist nuk iu përmbahet kodeve të etikës, mund t'i dëmtohet reputacioni apo shkatërrohet karriera e atij vetë, mund të dëmtojë apo shkatërrojë biznesin/klientin e tij, dhe në këtë mënyrë t'i bëjë dëm profesionit në tërësi.

Çështja e etikës së profesionit është njëra prej sfidave kryesore me të cilat ballafaqohet profesioni i kontabilitetit. Këtë do ta ilustrim me një shembull nga Europa dhe pastaj do të kthehem edhe në gjendjen në vendin tonë. Shoqata është bërë anëtare me të drejta në Federatën Europiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM-të/European Federation of Accountants and Auditors for SMEs (EFAA) nga viti i kaluar. Para disa muajsh EFAA ka publikuar një studim: Kontabiliteti dhe Etika: Presioni i përjetuar nga kontabilisti profesionist. Ky studim është bërë në mesin e kontabilistëve dhe auditorëve të NVM-ve në disa vende europiane, anëtare të BE-së. Në këtë studim thuhet se mbi 64% të respondentëve (kontabilistë dhe auditorë) kanë pranuar se ndaj tyre është ushtruar trysni që të vepronin në kundërshtim me etikën e tyre profesionale apo mnë kundërshtim me legjislacionin tatimor apo standardet relevante të kontabilitetit.

Mbi 88% e të anketuarëve kanë deklaruar se nuk iu është ofruar apo dhënë ndonjë shpërblim për një presion të tillë, përkundrazi kjo është lidhur më tepër me vazhdimësinë e angazhimit të tyre në kompani.

Ky studim mund të shkarkohet nga interneti në faqen e EFAA-s. Sa është ky studim relevant për Kosovën? Shoqata jonë, duke qenë anëtare e EFAA-s, ka kërkuar që në një zgjerim të këtij studimi të merret edhe përvoja e profesionistëve në Kosovë. Shumë shpejt te anëtarët tanë do të filloj në të vijnë emaillet me pyetësorët për çështjet e ndryshme etike me të cilat ballafaqohet profesionisti në Kosovë. Do të jetë me interes për ne si Shoqatë, për anëtarët tanë dhe për profesionin në përgjithësi që t'i shohim problemet, vështirësitë dhe sfidat me të cilat ata përballen dhe mënyrën se si duhet zgjidhur ato.

Është me rëndësi kritike që kontabilistët t'iu përmbahen parimeve etike. Kjo në radhë të parë ndërlidhet me kulturën etike të krijuar në familje dhe e cila bartet edhe në ushtrimin e profesionit. Në këtë drejtim sigurisht që ka rëndësi të madhe kultura e biznesit/klientit në të cilin vepron profesionisti. Prandaj është esenciale që parimet etike të përfshihen në të gjitha trajnimet, EVP-në dhe në shkollimin unjversitar.

## Nazmi Pllana Kryetar i Këshillit



*Nga e majta lart: Z. Fari Breznica, Z. Nazmi Pllana, Z. Burim Zagragja, Znj. Lindita Matoshi, Znj. Besa Berisha, Znj. Arbresha Tuhina, Znj. Aferdita Çarkaxhiu*



## MESAZH NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE

Të dashur Anëtarë,

15 vite sfidë, zhvillim, suksese, të gjitha këto ishin pjesë e festimit tonë në ketë vit.

Për këto 15 vite Shoqata ka arritur të jetë prijëse në rajon, të zhvilloj program të njohur ndërkombëtarisht, të përfaqësohet në organizata profesionale, të zhvilloj edhe programet e para globale për institucionet supreme si dhe ti vë anëtarët e saj në listat e profesionistëve të njohur ndërkombëtarisht.

Shoqata sot me mburrje i shpalos të gjitha këto arritje përkundër sfidave që na kanë përcjell, megjithatë ne si Shoqatë jemi të vetëdijshëm për sfidat me të cilat ballafaqohet vendi dhe profesioni dhe për tejkalimin e të cilave vazhdimisht jemi të angazhuar por që në fakt nuk varen tërësisht nga ne. Këtu në radhë të parë do ta përmendi Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim si një akt i domosdoshëm për zhvillim ekonomik, transparencë financiare, raportim të drejtë, si element kyç për investime dhe si akt i rëndësishëm për ne si profesionist.

Shoqata në çdo moment ka qenë e gatshme të ofroj ndihmë teknike dhe ekspertizë profesionale si dhe ka tërhequr interesin e donatorëve të cilët do të financonin jo vetëm draftimin e ligjit por edhe implementimin e tij dhe përkundër gjithë kësaj, sot ne mund të themi se lidhur me ketë çështje ende jemi në pikën zero.

Sekretariati i KKRF ende ballafaqohet me mungesë të stafit teknik edhe pse qysh nga raporti i parë i ROSK i lëshuar nga Banka Botërore në 2006 dhe pastaj në 2012-rekomandimet mbesin të njëjta, profesioni në përgjithësi dhe profesionistët ballafaqohen me probleme dhe sfida të njëjta si në vitet e para të pas luftës.

Hapja dhe licencimi i organizatave profesionale pa kriteret e mirëfillta dhe me pretekstin se konkurrenca është pozitive, për rrethanat në vendin tonë nuk duket të jetë arsyetim i justifikueshëm. Ky arsyetim edhe njëherë dëshmon se Kosova vuan për dijëni e sidomos atë profesionale, një organizatë profesionale e cila është e regjistruar si OJQ krahasohet me biznes në aspektin e konkurrencës!

Organizatave profesionale janë të themeluara nga profesionistët për të vetmin qëllim për zhvillimin, avancimin e profesionit dhe mbrojtjen e interesit publik. Në vendet e zhvilluara ekonomikisht nga dy organizata profesionale, njëra e sektorit privat dhe tjetra e sektorit publik, janë duke u integruar në një, për arsye të përballimit më të lehtë të shpenzimeve duke e ditur se shpenzimet për një organizatë profesionale të vetme për ti plotësuar të gjitha standardet të cilat dalin nga standard-vënësit global janë të mëdha, përdërisa në rajon dhe më konkretisht në vendet e Ballkanit duke përfshi edhe Kosovën në vitet e fundit hapen 2, 3 e më shumë organizata profesionale, gjë që edhe njëherë dëshmon se niveli i të kuptuarit për zhvillim profesional është ende i ulët.

E si mund të presim më shumë në zhvillim profesional kur rezultatet nga organizatat ndërkombëtare për edukim në përgjithësi në Kosovë janë shumë të ulëta. Një organizatë profesionale e posaçërisht në vende të vogla si Kosova duhet ti bashkoj të gjithë profesionistët, akademikët, politikanët të cilët duke marrë për bazë praktikat më të mira nga vendet me profesion të avancuar duhet të synojnë ekzistimin e vetëm një organizate profesionale të pavarur e cila nuk do të jetë e fokusuar në krijimin e numrit sa më të madh të profesionistëve por të ketë objektiv krijimin e profesionistëve me etikë dhe integritet të lartë. Por në rastin e Ballkanit, e që me keqardhje duhet ta pranojmë edhe në vendin tonë, interesi personal ka prekur edhe edukimin. Rreziku më i madh për mos zhvillim të një shteti është mos edukimi i mirëfilltë.

Ne si Shoqata për këto 15 vite mund të krenohemi për të gjitha proceset dhe zhvillimet e posaçërisht në edukim të anëtarëve tanë. Anëtarët e Shoqatës sot kanë vend të respektuar në shoqërinë tonë falë nivelit më të lartë të zhvillimit profesional në të cilën gjenden, etikës të lartë dhe integritetit personal dhe profesional.

Duke e venë në rend të parë profesionalizmin e saj Shoqata për 15 vjetorin e saj vendosi të ngrit zërin e saj për zhvillimin e profesioneve të cilët do të ndihmojnë në zhvillim ekonomik, hapjen e vendeve të punës, bashkëpunimin me biznese për të

plotësuar kërkesat e tyre me profesionistë në lëmi të ndryshme dhe ajo më e rëndësishmja të ju ofrohet të rinjve mundësi për tu përcaktuar për karrierën e tyre në mënyrë që ata të jenë të kërkuar në tregun e Kosovës. Të duan zhvillimin e vendit të tyre dhe mos të kërkojnë largimin nga Kosova për të kërkuar jetë më të mirë, por të krijojnë atë jetë këtu.

Forumi “Specializimi Profesional – Domosdoshmëri për Zhvillim Ekonomik” i organizuar nga Shoqata iu ofroi atë mundësi të gjithëve. Tanimë jemi duke i parë rezultatet e kësaj nisme, kur shumë donatorë, organizata vendore si dhe vet qeveria i kanë fokusuar agjendat e tyre në këtë drejtim. Në fund mesazhi im jo vetëm si udhëheqëse e Shoqata por edhe si prind është:

Edukimi i mirëfilltë dërgon drejt zhvillimit jo vetëm individual por edhe zhvillim të vet shtetit, mos investimi në edukim dërgon një shtet drejt varfërisë, urrëjtjes dhe pakënaqësisë sociale.

Ne jemi ata që duhet të vendosim të ardhmen tonë dhe të fëmijëve tanë, secili nga ne mund të kontribuoj në zhvillim e posaçërisht ju anëtarë të Shoqatës, sepse ju jeni profesionistë dhe ju mund të drejtoni gjeneratat e reja drejt edukimit profesional me etikë të lartë dhe integritet.

## **Ardiana Bunjaku Drejtoreshë Ekzekutive**



*Nga e majta lart: Arbër Hoti, Dafina Prekazi, Nora Jusufi, Ardiana Bunjaku, Lendita Shahini, Teuta Karqmeta, Edona Perjuci-Uka, Burbuqe Gjonbalaj, Ermal Kozgori, Torvioll Ukëhaxhaj, Lulzim Zeka, Burim Ahmeti, Art Navakazi*

## AKTIVITETET QË KARAKTERIZUAN VITIN 2016

Viti 2016 ishte një vit shumë dinamik dhe i suksesshëm për Shoqatën në aspektin e shtrirjes së përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje të organizuara në vend, rajon dhe në nivel ndërkombëtar.

Në pajtim me Strategjinë katër vjeçare 2015-2019 të aprovuar nga Asambleja si dhe planin e punës për vitin 2016, Shoqata ka përmbushur të gjitha objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2016.

Si e vetmja organizatë nga Kosova, e anëtarësuar me të drejta të plota në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve dhe në përputhje me kërkesat e Deklaratës së Obligimeve të Anëtarësisë (DOA), Shoqata ka vazhduar të zbatojë standardet ndërkombëtare për zhvillimin e mëtutjeshëm të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit si dhe për zhvillimin afatgjatë të anëtarëve të saj. Si çdo vit edhe gjatë vitit 2016 është raportuar në FNK mbi aktivitetet e shoqatës, numrin dhe pagesat e anëtarësisë si dhe për pasqyrat financiare, proces ky që është sistematik dhe mbikëqyret nga FNK.

Po ashtu Shoqata ka implementuar kërkesat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim si dhe të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 për Procedurat e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit të Cilësisë së punës së Shoqatave të Licencuara, Firmave të Auditimit dhe Auditorëve Ligjor. Kështu në këtë drejtim është raportuar rregullisht çdo vit në KKRF mbi punën e Shoqatës, duke përfshirë raportet mbi anëtarësinë, ligjëruesit, kalueshmërinë në provime, arritjen e titujve të anëtarëve, raport mbi procedurat e hetimit dhe disiplinës, Kodi i Etikës si dhe një varg dokumente dhe raporte tjera.

Duke qenë prijëse e profesionit dhe bartëse e ndryshimeve në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, Shoqata vazhdon të punojë në mbrojtje të interesit publik, me qëllim të fuqizimit dhe mbështetjes së profesionit.

Me qëllim të sensibilizimit të profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit dhe në përpjekje për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies si në menaxhimin e parasë publike ashtu edhe në ngritjen e besueshmërisë së raportimit financiar, këtë vit Shoqata ka realizuar një varg bashkëpunimesh me organizata dhe akterë kyç të profesionit në nivel ndërkombëtar dhe vendor.

Si pjesë e trendeve globale, roli i Shoqatës në zhvillimin e qëndrueshëm të profesionit, këtë vit u fuqizua edhe më shumë me anëtarësimin në Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (EFAA).

Me këtë rast, përfaqësuesi i EFAA Z. Felix Martens vlerësoi se *"Anëtarësimi i SHKÇAK në Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) do të thotë shumë për Kosovën si një shtet që synon anëtarësimin në BE, sepse tani kontabilistët dhe auditorët e Kosovës përmes SHKÇAK kanë zërin e tyre në mekanizma evropiane, gjegjësisht në EFAA."*

Përmes këtij anëtarësimi, profesionistët vendorë-anëtarë të Shoqatës bëhen pjesë e kësaj organizate evropiane, e cila ka nën ombrellën e vet më shumë se 320.000 anëtarë profesionistë të kontabilitetit, auditimit dhe këshilltarë tatimorë, që vijnë nga shtetet e Evropës.

Sa i përket zhvillimeve në vend, gjatë vitit 2016 Shoqata ka punuar intenzivisht që të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar në Agjensionin Kombëtar të kualifikimeve. Edhe pse shoqata është aprovuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) që nga viti 2002, megjithatë u angazhua edhe në akreditimin e programeve të saj, ku pas një procesi të gjatë të vlerësimit të kurrikulumeve, AKK akreditoi të gjitha çertifikuese të Shoqatës.

## FORUMI “SPECIALIZIMI PROFESIONAL-DOMOSDOSHMERI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK”

Viti 2016 u karakterizua me aktivitetet e shumta me rastin e 15 vjetorit, në kuadër të së cilave u mbajt edhe Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë në të cilën u zgjodhën anëtarët e ri të Këshillit, të cilët do ta udhëheqin shoqatën për dy vitet e ardhshme, u votuan anëtarët e rinj të Komisionit Disiplinor, u votua dhe u aprovua Raporti financiar i audituar, Raporti vjetor 2015 si dhe Plani i punës dhe buxheti për vitin 2017.

Ndërsa aktiviteti kryesor për ta shënuar këtë përvjetor jubilar ishte organizimi i Forumit “Specializimi profesional-Domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik”, me qëllim të sensibilizimit të rëndësishëm të zhvillimit profesional dhe promovimit të specializimit profesional të individëve. Kjo ngjarje e cila për herë të parë u organizua në një format të tillë në Kosovë, shënoi fillimin e një ere të re që ka të bëjë me sensibilizimin e politik bërësve, Institucioneve arsimore, bizneseve dhe të gjithë akterëve relevantë, për rëndësinë e ngritjes dhe zhvillimit të profesionistëve në profile të ndryshme.

Kjo ngjarje është përcjellë edhe nga mediat e shumta, ku përfaqësuesit e shoqatës ishin edhe pjesë dhe mysafirë të shumë emisioneve televizive dhe atyre në radiot kosovare.

Mijëra të rinj në vend nuk mund të gjejnë punë, si pasojë e mungesës së aftësive të specializuara profesionale të nevojshme për tregun e punës në Kosovë, gjë që ndikon në rritjen e nivelit të papunësisë dhe varfërisë në vend.

Ideja e një ekonomie të suksesshme, ka anashkaluar shumë shtylla kyçe duke konsideruar si të vetmen rrugë edukimin tradicional universitar, i cili fatkeqësisht si i vetëm nuk ka arritur t'i pajisë individët me aftësi praktike dhe ka krijuar boshllëk të madh në industrinë prodhuese dhe shërbyese të vendit tonë. Edhe pse akterë të ndryshëm në Kosovë kanë hapur diskutimin mbi këtë çështje, organizimi i Forumit ishte një mundësi për shumë zëra të padëgjuar nga shumë fusha, që të ofrojnë zgjidhje dhe të jenë edhe vetë pjesë e saj.

Në hapje të forumit Ministri i Financave Z. Avdullah Hoti vlerësoi lart punën e Shoqatës si dhe u zotua se “do të mbështesë iniciativën e Shoqatës për ngritjen e vetëdijesimit mbi vlerën e edukimit profesional si një faktor kyç për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik”.



Ministri i Financave i Republikës së Kosovës Z. Avdullah Hoti



Kryetari i Këshillit të ShKÇAK Z. Shaban Muharremi

Pjesëmarrësit në Forum, të cilët ishin përfaqësues të zërit të përbashkët të profesionistëve të fushave të ndryshme së bashku me të gjitha bizneset, shoqatat profesionale, institucionet e edukimit profesional dhe studentët që janë në rrugë për t'u profilizuar, bënë që debatet dhe diskutimet të jenë shumë interaktive.

### ***Ngritja e kapaciteteve profesionale në funksion të zhvillimit ekonomik***

Gjatë panelit të parë me temën “Ngritja e kapaciteteve profesionale në funksion të zhvillimit ekonomik”, të udhëhequr nga Z. Lekë Musa themelues i SHKÇAK, me panelistë që përfaqësonin institucionet qeveritare, edukative, biznesore si dhe donatorët, Z. Arban Abrashi, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Z. But Dedaj, Dekan i Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Hasan Prishtina”, të Prishtinës, Z. Ilir Aliu, drejtor gjeneral në Pro-Credit Bank, Z. Nikolaos Moussouras, Drejtor Financiar i Sharrcem, Z. Driton Hapçiu, Themelues dhe Partner Menaxhues, Cactus, Z. Terry Slywka, Shef i Zyrës-Programi Partneritete për Zhvillim të USAID, Z. James Macbeth Forbes, Drejtor në GIZ, Z. Milot Hasangjekaj, Ekspert për Kualifikime në Autoritetin Kombëtar për Kualifikime, Znj. Ardiana Bunjaku, Drejtoreshë Ekzekutive e ShKÇAK, u diskutua për mangësitë ekzistuese në kurrikulumet dhe programet edukative si dhe mënyrat se si këto kurrikulume duhet të zhvillohen më për së afërmi me kërkesat e tregut të punës.



*Paneli i diskutimit: “Ngritja e kapaciteteve profesionale në funksion të zhvillimit ekonomik”*

*Nga e majta: James Macbeth Forbes, Terry Slywka, Driton Hapçiu, Nikolaos Moussouras, Ilir Aliu, But Dedaj, Milot Hasangjekaj, Arban Abrashi, Ardiana Bunjaku*

## Rekomandimet nga Paneli “Ngritja e kapaciteteve profesionale në funksion të zhvillimit ekonomik”

Duke pasur parasysh zhvillimin e dobët ekonomik dhe numrin e lartë të të papunësuarve në Kosovë dhe pas adresimit të sfidave me të cilat është duke u ballafaquar ekonomia e Kosovës, rekomandohet që të organizohet një tryezë e rrumbullakët me panelistët pjesëmarrës në forum - përfaqësues të bizneseve, universiteteve, qeverisë dhe donatorëve ku pritet të diskutohet rreth mundësive për zhvillimin e një hulumtimi të tregut të punës.

- Në bazë të të gjeturave të hulumtimit, të përpilohet strategjia e zhvillimit të programeve të qëndrueshme për fushat me potencial për zhvillim.
- Bashkëpunimi në mes të gjitha palëve të interesit do të ndihmojë koordinimin e fondeve të nevojshme për implementim të zhvillimit të strategjisë dhe planit të veprimit.
- Fokus të veçantë duhet të ketë koordinimi i donatorëve si kërkesë bazike për zhvillim dhe bashkëpunim më efikas në mbështetjen e projekteve zhvillimore – në këtë rast mbështetjen e zhvillimit të programeve profesionale në fusha të ndryshme.
- Të krijohet bashkëpunim më intensiv në mes të bizneseve dhe institucioneve arsimore për të krijuar kurrikulume sipas kërkesave të tregut.
- Të ketë vazhdimësi të organizimit të forumeve të tilla ku promovohen specializimet në fushat të cilat rezultojnë nga hulumtimi të jenë më të kërkuara.
- Pas diskutimeve panelistët shprehën gatishmërinë për bashkëpunim për krijimin e një strategjie duke ofruar modalitete për krijimin e programeve të qëndrueshme dhe për të krijuar bashkëpunime në mënyrë që secili sektor të japë kontributin e vet në këtë drejtim. Ndërsa, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Z. Arban Abrashi konkludoi se, nga ky forum mund të krijojmë partneritet, të cilat do të ndihmojnë në zbutjen e papunësisë në Kosovë





## ***Roli i kontabilitetit dhe auditimit në mbrojtje të interesit publik***

Gjatë Forumit gjithashtu rëndësi e veçantë iu dha edhe diskutimit mbi “Rolin e kontabilitetit dhe auditimit në mbrojtje të interesit publik”, i cili u udhëhoq nga Z. Nazmi Pllana, Kryetar i ShKÇAK-së. Panelistët, të cilët përfaqësonin institucionet qeveritare, rregullatorët, administratën tatimore, organizatat relevante ndërkombëtare, Z. Sakip Imeri, Drejtor i Administratës Tatimore të Kosovës, Z. Gem Maloku, Kryetar i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, Z. Brian Donnellan, Udhëheqës i zhvillimit të tregut global, CIPFA, Z. Jan Tyl, Konsulent në Bankën Botërore, Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar, Z. Felix Martens, Koordinator i projekteve, Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve, Z. Hysen Çela, Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Z. Zoran Skobic, Drejtor i edukimit dhe marrëdhënieve Ndërkombëtare, Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Serbisë, diskutuan sfidat e implementimit të kërkesave ligjore, standardeve ndërkombëtare dhe direktivave të BE për integrim evropian, në një ekonomi në tranzicion. Gjatë diskutimeve u morën edhe shembuj nga vendet e rajonit si dhe vendet e zhvilluara dhe si të gjendet mënyra më e mire për tejkalimin e këtyre sfidave, me të cilat përballën vendet në zhvillim.

Njëri ndër panelistët, Z. Jan Tyl, Këshilltar në Bankën Botërore si dhe themelues i ShKÇAK theksoi se *"Sa i përket edukimit profesional, ajo çfarë e kemi hasur ne si Bankë Botërore në rajon është fakti se nuk ka vullnet për bashkim të të gjitha palëve për të zhvilluar një sistem të mirëfilltë të raportimit financiar dhe auditimit në të mirë të interesit publik."*



*Paneli i diskutimit: "Ngritja e kapaciteteve profesionale në funksion të zhvillimit ekonomik"*

*Nga e majta: Nazmi Pllana, Brian Donnellan, Felix Martens, Jan Tyl, Gem Maloku, Sakip Imeri, Hysen Çela, Zoran Skobic*

## Rekomandimet nga Paneli “Roli i kontabilitetit dhe auditimit në mbrojtje të interesit publik”

Duke pasur parasysh ambiciet e Kosovës për t'u renditur në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare, korniza e raportimit financiar dhe kontabilitetit do të duhet të respektojë direktivat e BE-së në lidhje me standardet ndërkombëtare të edukimit, raportimit financiar, auditimit dhe kontrollit të cilësisë. Për këtë qëllim është e domosdoshme që Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim t'i përfshijë të gjitha kërkesat e direktivave të lartpërmendura dhe standardeve ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë të jetë ligj i cili është i zbatueshëm në ambientin e Kosovës.

- Të gjitha palët e interesit duhet të bashkëpunojnë drejt ndërtimit të sistemeve efektive të menaxhimit, raportimit financiar dhe auditimit në të gjithë sektorët e ekonomisë, duke ofruar zgjidhjet e mundshme për arritjen e stabilitetit financiar përmes ndërtimit të kapaciteteve, besueshmërisë dhe sistemeve për një rregullim efektiv.
- Në kontekst të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Kosova do të duhej të jetë e vëmendshme që të gjendet një ekuilibër për disiplinë fiskale duke ju referuar standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Të punohet në adresimin e sfidave që dolën nga diskutimi në panel për zhvillimin e profesionit në Kosovë drejt implementimit të standardeve ndërkombëtare krahasuar me shtetet e zhvilluara.
- Të promovohet sistemi i sigurimit të cilësisë duke krijuar kështu klimën për mbikëqyrje dhe në këtë drejtim të qartësohet roli i palëve me interes, përfshirë këtu KKRF, Bankën Qendrore të Kosovës si dhe organizatat profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve.



## Sesionet paralele – ofrim i njohurive për specializime profesionale

Forumi ofroi edhe sesione paralele me qëllim që të interesuarit, si punëkërkuessit ashtu edhe punëdhënësit të kenë mundësinë të njoftohen me ofertat për kualifikimet të cilat ofrohen në Kosovë, ndërsa të rinjtë të cilët ende nuk janë orientuar për karrierën e tyre të informohen për kërkesat e tregut në vend. Rëndësia e forumit ndikoi që numri i pjesëmarrësve të kalojë mbi 1000.



**Sesioni “Çertifikimet e ShKÇAK - Rrugë për përfitimin e njohjeve ndërkombëtare”**, ofroi informata për spektrin e gjerë të çertifikimeve që ofron Shoqata, e që kanë të bëjnë me profesionin e kontabiliteti dhe auditimit, qoftë për sektorin privat apo edhe publik. Prezantuesit Znj. Teuta Karameta, Udhëheqëse e Departamentit për Çertifikime të Sektorit Publik dhe Z. Art Navakazi, zëvendës-drejtor në ShKÇAK, theksuan se *“në cilëndo fazë të karrierës tuaj në financa dhe kontabilitet të jeni, ShKÇAK ka një kualifikim i cili do t’ju përshtatet juve dhe karrierës suaj”*.

**Sesioni “Sigurimi i Cilësisë - Mjet për ngritjen e besueshmërisë së raportimit financiar”**, u prezantua nga Z. Arbër Hoti, Udhëheqës i Departamentit të Sigurimit të Cilësisë në ShKÇAK, i cili theksoi rëndësinë e rolit të auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore në mbrojtje të interesit publik, nëpërmjet të zbatimit të drejtë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe respektimit të kërkesave të cilat dalin nga Kodi i Etikës të lëshuara nga FNK. Ky sesion iu kushtua rolit që ka një sistem efikas i sigurimit të cilësisë në ngritjen e besueshmërisë në pasqyrat financiare.



Sesioni: “Çertifikimet e ShKÇAK-Rrugë për përfitimin e njohjeve ndërkombëtare”

Sesioni: “Sigurimi i cilësisë-Mjet për ngritjen e besueshmërisë së raportimit financiar”

**Sesioni “Kreativiteti si profesion: mundësitë e specializimit profesional në dizajn dhe format e ndryshme të qasjes”,** u prezantua nga Znj. Arta Agani ligjëruese në Akademinë Evolucion dhe Z. Arsim Shala, Udhëheqës i Xhad-Studio, të cilët folën për mundësitë dhe sfidat me të cilat artistët ballafaqohen në Kosovë. Prezantuesit theksuan se *“Të qenit artist dhe të konceptuarit kreativ të botës nuk mjafton për të siguruar ekzistencën e as për të funksionalizuar një individ për të qenë anëtar produktiv i shoqërisë. Sepse kreativiteti në ditët e sotme është shndërruar në biznes dhe duhet përshtatur kërkesave të tregut dhe klientëve”.*

**Sesioni “Reforma e Auditimit të BE-së dhe raportimi i zgjeruar i Auditorëve”,** u prezantua nga Znj. Tzvetelina Koleva, Partnere e Auditimit në KPMG, në Bullgari. Znj. Koleva foli për ndryshimet e legjislacionit të BE-së, që kanë filluar të aplikohen nga qershori 2016, si dhe ndikimet që kanë këto ndryshime në shërbimet të cilat mund t'i ofrojnë auditorët tek klientë të auditimit. Disa prej ndryshimeve do të përfshijnë qarkullimin e obliguar të firmës, ndalesat në shërbime jo të auditimit, mbikëqyrje të shtuar nga Komiteti i auditimit dhe raportim te ky Komitet dhe tarifa për shërbimet e lejuara të cilat nuk janë shërbime të auditimit.



*Sesioni: “Kreativiteti si profesion: mundësitë e specializimit profesional në dizajn dhe format e ndryshme të qasjes”*



*Sesioni: “Reforma e Auditimit të BE-së dhe raportimi i zgjeruar i Auditorëve”*

**Sesioni “Burimet njerëzore si mjet strategjik i zhvillimit të biznesit, qendrat e vlerësimit si strategji rekrutimi te kompanitë”,** u prezantua nga Znj. Dafina Turkeshi-Ballanca dhe Znj. Florentina Dushi-Shehu, bashkëthemeluese dhe drejtuese të Business Development Group. Në këtë sesion u diskutua për integrimin e strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe sistemeve të kompanive në raport me nevojat e punëtorëve dhe të grupeve të tjera të interesit.

**Sesioni “Roli i partneritetit financiar në biznes”,** u prezantua nga Z. Brian Donnellan, përfaqësues i CIPFA, i cili vuri në pah rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve në sektorin publik, aftësitë kyçe të kërkuara dhe përfitimet kryesore për individë, organizimin dhe funksionin e menaxhimit të financave publike.



*Sesioni: “Burimet njerëzore si mjet strategjik i zhvillimit të biznesit, qendrat e vlerësimit si strategji rekrutimi te kompanitë”*



*Sesioni: “Roli i partneritetit financiar në biznes”*

**Sesioni “Mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive në mes të institucioneve kërkimore dhe sektorit të biznesit në Kosovë”,** u prezantua nga Z. Gent Beqiri dhe Z. Endrit Pllashniku, nga Instituti RIINVEST. Prezantuesit folën për metodologjinë e punës kërkimore të këtij Instituti, aftësitë që duhet t'i ketë një ekip i angazhuar në kërkime dhe metodologji rigorozë të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, mënyrës se si mund të fitohen këto aftësi si dhe rëndësinë dhe mundësitë e bashkëpunimit të ngushtë mes institucioneve kërkimore dhe sektorit të biznesit.



*Sesioni: “Mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive në mes të institucioneve kërkimore dhe sektorit të biznesit në Kosovë”*

**Sesioni “Trendet dhe zhvillimet e fundit në industrinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe shkathtësitë më të kërkuara në tregun e punës”,** u prezantua nga Z. Blerim Jahiu, Instruktor, Cisco Networking Academy dhe Konsulent për IT, në AUK, i cili theks të veçantë iu dha shkathtësive dhe aftësive që duhet t'i kenë kandidatët potencialë në tregun e punës e që ndërlidhet me industrinë e TIK-ut si dhe problematika e trajnimit dhe edukimit joformal të kandidatëve në profile të ndryshme në këtë industri.



*Sesioni: “Trendet dhe zhvillimet e fundit në industrinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe shkathtësitë më të kërkuara në tregun e punës”*

**Sesioni “Rëndësia e teknologjisë për raportim financiar të besueshëm, faktor lehtësues për MSA”,** prezantuar nga Znj. Melita Ymeraga dhe Z. Visar Lluka, trajtoi çështje që kanë të bëjnë me rëndësinë që ka teknologjia për raportim financiar, e që është një parakusht i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). MSA u mundëson kompanive vendore qasje në tregun e BE-së me kushte më të mira, prandaj nevojitet avancimi i kulturës së kontabilitetit menaxherial dhe financiar, në mënyrë që partnerët potencialë të kuptojnë me lehtësi njëri-tjetrin.



*Sesioni: “Rëndësia e teknologjisë për raportimin financiar të besueshëm”*

**Sesioni “Përfitimi i shkathtësive nga arsimi profesional në fushën e TIK-ut dhe qasja më e lehtë në tregun vendor dhe ndërkombëtar”,** i prezantuar nga Znj. Vildane Kelmendi dhe Z. Kastriot Fazliu, nga Cactus Education, iu kushtua rëndësisë së arsimit profesional në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në vendin tonë, për një përgatitje profesionale bazuar në praktikat më të mira vendore dhe ndërkombëtare.



*Sesioni: “Përfitimi i shkathtësive nga arsimi profesional në fushën e TIK-ut dhe qasja më e lehtë në tregun vendor dhe ndërkombëtar”*

Sesioni “Ndikimi i teknologjisë bashkëkohore në ngritjen artistike e profesionale”, u prezantua nga Z. Ilir Bajri, pianist dhe kompozitor si dhe themelues i Prishtina Jazz Festival. Z. Bajri trajtoi pozicionin e artistit në raport me zhvillimin e vullshëm teknologjik, i cili mundëson përparim dhe zhvillim të shpejtë dhe produktiv artistik e profesional, për përparësitë dhe dobitë nga njohja, mësimi dhe përdorimi i veglave bashkëkohore teknologjike dhe përfshirjen e tyre në procesin e mësimin dhe zhvillimit profesional.

Sesioni “Roli i Teknologjisë së Informacionit (TI), në Ndërmarrësi dhe i Ndërmarrësisë në TI”, u prezantua nga Z. Hazir Gashi, Udhëheqës i Akademisë së Professionistëve, Kolegji Riinvest. Sesioni trajtoi domosdoshmërinë e njohurive të ndërsjella për ndërmarrësi dhe Teknologji të Informacionit dhe nevojën e bashkëpunimit mes ndërmarrësve dhe ekspertëve të TI. Z. Gashi theksoi se “Ndërmarrja bashkëkohore gjithnjë e më shumë është e varur nga risitë, që sjell zhvillimi i TI dhe nevojën e zbatimit të tyre, mirëpo edhe njohësit e TI duhet të njohin mirë trendet e Ndërmarrësisë, që të jenë në gjendje të zhvillojnë një biznes të suksesshëm”.



Sesioni: “Ndikimi i teknologjisë bashkëkohore në ngritjen artistike e profesionale”



Sesioni: “Roli i Teknologjisë së Informacionit në Ndërmarrësi dhe i Ndërmarrësisë në TI”



Audienca në Forumin “Specializimi Profesional-Domosdoshmëri për Zhvillimin Ekonomik”

### ***Panair i bizneseve dhe institucioneve edukative***

Si pjesë e aktiviteteve të forumit ishte edhe prezantimi i veprimtarisë së rreth 20 bizneseve dhe Institucioneve edukative të cilët shfrytëzuan këtë mundësi për të ofruar informata, këshilla dhe mundësi për zhvillim të karrierës për pjesëmarrësit, me fokus tek studentët dhe punë-kërkuesit. Përfaqësuesit e bizneseve po ashtu patën rastin të prezantojnë aktivitetet biznesore dhe punën e tyre në shtandet e vendosura për këtë qëllim në hapësirën ku po organizohej Forumi.

Bizneset, Institucionet edukative dhe organizatat të cilat prezantuan veprimtarinë e tyre ishin: A.U.K Training and Development Institute, Kolegji Riinvest, Kolegji Universum, Cactus Education-Shkollë e Lartë Profesionale, Vala Consulting, BDO, ProCredit Bank, Banka për Biznes, Oda Ekonomike Amerikane, abd & associates, Audit & Consulting Associates, Baker Tilly Kosovo, Fryti Audit, KEDS, KPMG Albania, Deloitte, Melita & Partners, Certus Solutions.



*Panairi i bizneseve dhe institucioneve edukative*

## SHKÇAK ANËTARËSOHET EDHE NË FEDERATËN EVROPIANE TË KONTABILISTËVE DHE AUDITORËVE PËR NVM

Me rastin e shënimit të 15 vjetorit, ShKÇAK arriti edhe një sukses me anëtarësimin e saj në Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (EFAA) gjë që dëshmon edhe një here përkushtimin e saj për përmbushjen e standardeve më të larta profesionale. Me anëtarësimin në këtë federate, ShKÇAK do të ketë mundësinë të ushtrojë ndikimin për shkëmbimin e përvojave në zhvillimin e standardeve dhe udhëzuesve edhe për vendet në tranzicion.

Nënshkrimi i anëtarësisë u bë gjatë takimit vjetor ku Z. Felix Martens, EFAA e cilësoi ShKÇAK si një organizatë me ndikim, e cila ka arritur të zhvillojë profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në vend dhe të shtrijë përfaqësimin e vet në të gjitha Organizatat dhe Federatat me renome dhe me ndikim në botë. Ndërsa Z. Shaban Muharremi, Kryetar i ShKÇAK në emër të anëtarëve të Shoqatës siguroi përfaqësuesit e EFAA-së se “ShKÇAK do të jetë një anëtare e përkushtuar për zbatimin e misionit dhe vizionit të EFAA-së po ashtu edhe në implementimin e standardeve për NVM në Kosovë përmes anëtarëve të saj.”



*Nga e majta: Z. Shaban Muharremi, Znj. Ardiana Bunjaku, dhe Z. Felix Martens*



## SHKÇAK DHE INSTITUTI I AUDITORËVE TË ÇERTIFIKUAR TË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit në rajon, ku ShKÇAK deri më tani ka pasur marrëveshje bashkëpunimi vetëm me IEKA, në vitin 2016 ka zgjeruar bashkëpunimin e saj edhe me Institutit të Auditorëve të Çertifikuar të Republikës së Maqedonisë (IORRM).

Ky bashkëpunim ka për qëllim zhvillimin dhe implementimin e planeve të veprimit në përputhshmëri me Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) për Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK/IFAC), kualifikimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të profesionit, kontributin bilateral në të praktikuarit e sigurimit të cilësisë, bashkëpunimin në shkëmbimin e materialeve arsimore dhe fuqizimit të rolit të kontabilistëve dhe auditorëve si dhe të vetë profesionit në të dyja shtetet.



*Kryetari i ShKÇAK-së, Z. Nazmi Pllana dhe  
Kryetari i IORRM, Z. Borislav Atanasovski*



*Përfaqësuesit e ShKÇAK dhe IORRM*

## SHOQATA VAZHDON ME SUKSESET E SAJ – NJOHJE RECIPROKE E ÇERTIFIKIMEVE

Falë punës së mirë dhe angazhimit të Shoqatës që programet certifikuese që ofrohen në kuadër të trajnimeve të jenë në përputhje me Direktivat e BE-së, Standardet Ndërkombëtare të edukimit të sektorit publik dhe privat si dhe kërkesat e DOA të FNK-së, programet certifikuese të Shoqatës janë ranguar të barasvlershme me programet që ofrohen nga Shoqatat që veprojnë në nivel ndërkombëtar.

### Anëtarët e ShKÇAK edhe anëtare të CIPFA

Gjatë vitit 2016, ShKÇAK ka funksionalizuar marrëveshjen e bashkëpunimit me CIPFA, me ç'rast anëtarëve të saj të sektorit publik u është mundësuar anëtarësimi me të drejta të plota në CIPFA. Tanimë auditorët e çertifikuar të sektorit publik, 5 anëtarë të Shoqatës, do të jenë edhe anëtarë të CIPFA me çka fitojnë të drejtën të punojnë edhe në vendet e tjera, pasi që me këtë çertifikim të dyfishtë ata kanë arritur t'i plotësojnë të gjitha kërkesat të cilat dalin nga Institucionet ndërkombëtare për sektorin publik.

### Kontabilistët dhe Auditorët e çertifikuar të Shoqatës - anëtarë të Shoqatës së Kontabilistëve të çertifikuar të Britanisë së madhe

ShKÇAK ka nënshkruar marrëveshje për njohje reciproke edhe me Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar (AAT) me bazë në Britani të Madhe, e cila u mundëson anëtarëve të Shoqatës të ushtrjnë profesionin edhe jashtë kufijve të Kosovës. Kontabilistët dhe Auditorët e Çertifikuar të ShKÇAK-së nga viti 2017 do të mund të përfitojnë thirrje nga AAT.

### Programi i ShKÇAK-së akreditohet edhe ne Menaxhimin e performancës nga ACCA

ShKÇAK me azhurnimin e materialeve të saj demonstroi që është gjithmonë në hap me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE) dhe në këtë drejtim përafroi kurrikulumin e saj me ACCA ku pas vlerësimit të detajuar u akreditua edhe në lëndën e Menaxhimit të Performancës.

Anëtarët e Shoqatës, nga ky vit do të kenë mundësinë të akreditohen në 7 lëndë duke përfshirë edhe lëndën e lartpërmendur.

### ShKÇAK akreditohet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

ShKÇAK që nga themelimi ka zhvilluar programet e saj sipas kërkesave ligjore të dala nga Rregullorja e UNMIK-ut me Nr. 2001/30 dhe me Ligjin Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, korniza ligjore të cilat e rregullojnë profesionin. Edhe pse kërkesat ligjore për licencim të shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit janë në kuadër të ligjit të lartpërmendur, ShKÇAK gjatë vitit 2016 ka aplikuar për akreditim të programeve certifikuese në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK). Ligji për Kualifikime Kombëtare Nr. 03/L-060, neni 3, paragrafi 3 përcakton se **“Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve i krijuar sipas dispozitave të këtij ligji rregullon edhe dhënien e kualifikimeve brenda kornizës, me përjashtim të kualifikimeve të cilat rregullohen me dispozitat e ligjit për arsimin e lartë dhe kualifikimet të cilat rregullohen saktësisht edhe me dispozitat e ligjeve të tjera”**. Përkundër këtij fakti, se profesioni rregullohet nga një ligj tjetër, ShKÇAK është shprehur e gatshme të plotësojë edhe këtë kërkesë e cila për të nuk është obligative.



Si rrjedhojë, pas një procesi të gjatë të vlerësimit, Shoqata është akredituar dhe validuar edhe nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në të gjitha nivelet e programeve çertifikuese të saj:

- Teknik i Kontabilitetit; Niveli 4 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)
- Kontabilist i Çertifikuar; Niveli 5 sipas KKK
- Auditor i Çertifikuar; Niveli 5 sipas KKK
- Auditor i Çertifikuar i sektorit publik; Niveli 5 sipas KKK
- Auditor i Brendshëm i Çertifikuar; Niveli 5 sipas KKK
- Asistent i Institucionit shtetëror të auditimit; Niveli 5 sipas KKK
- Auditor i Institucionit shtetëror të auditimit; Niveli 5 sipas KKK
- Auditor i Çertifikuar i Institucionit shtetëror të auditimit; Niveli 5 sipas KKK

### **ShKÇAK zgjeron bashkëpunimin me Institucionet e Arsimit të Lartë në vend**

ShKÇAK si pjesë të strategjisë së saj gjithmonë i ka dhënë rëndësi bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në mënyrë që gjeneratat e reja qysh në hapat e parë të përcaktimit për karrierën e tyre të arrijnë njohuri me standardet ndërkombëtare të profesionit. Në këtë drejtim, edhe në vitin 2016, Shoqata ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universitetin “Haxhi Zeka” (UHZ) në Pejë. ShKÇAK ka shprehur gatishmërinë që plan-programet si dhe provimet e saj të cilat azhurnohen çdo vit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit (SNE) t'i ndajë me këtë Universitet. Në të njëjtën kohë, përfaqësuesit e UHZ e kanë mirëpritur ndihmën e Shoqatës duke u zotuar në një bashkëpunim më të përafërt me ShKÇAK për azhurnimin e kurrikulës së këtij Universiteti dhe që do t'i mundësojë gjeneratave të reja edukimin sipas SNE-ve.



*Nga e majta, Z. Fadil Millaku dhe Z. Shaban Muharremi*



*Përfaqësuesit e ShKÇAK dhe Universitetit “Haxhi Zeka”*

## PËRFAQËSIMI I SHKÇAK NË NGJARJE DHE AKTIVITETE NË VEND, RAJON DHE BOTË

ShKÇAK si një organizatë me ndikim që ka arritur të ndërtojë një reputacion brenda dhe jashtë vendit dhe e anëtarësuar në mekanizmat më të rëndësishëm ndërkombëtar edhe këtë vit ka qenë pjesë aktive e takimeve dhe konferencave në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

### Pjesëmarrja në takimin e 39-të të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve

Intensifikimi i aktiviteteve profesionale me ndikim afatgjatë në reduktimin e mundësisë dhe kërkesës për mashtrim dhe korrupsion, ishin temat të cilat u diskutuan në takimin e 39-të të Këshillit të anëtarëve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK). Gjatë takimit të Asamblesë së FNK-së, vlen të theksohet se u votua Kryetari dhe Nënkryetari si dhe anëtarët e tjerë të Bordit që do të udhëheqin FNK-në gjatë dy viteve të ardhshme. Po ashtu, gjatë këtij takimi janë organizuar edhe sesione paralele të cilat i dhanë mundësinë pjesëmarrësve të organizatave profesionale, anëtare me të drejta të plota në FNK, të diskutojnë lidhur me zhvillimet e fundit si dhe të shprehin qëndrimet e tyre për udhëzuesit të cilët do të implementohen në vitet në vijim.

Përfaqësuesit e ShKÇAK, Z. Nazmi Pllana, Znj. Ardiana Bunjaku dhe Z. Art Navakazi patën mundësinë të takohen me përfaqësues të organizatave profesionale, rregullatorët dhe institucionet e tjera globale, ku diskutuan lidhur me bashkëpunimet e mundshme në fushën e edukimit për shkëmbimin e përvojave praktike si nga organizata profesionale po ashtu edhe nga rregullatorët.



*Nga e majta, Z.Nazmi Pllana, Znj.Rachel Grimes, Znj.Ardiana Bunjaku dhe Z.Art Navakazi*



*Nga e majta, Z.Nazmi Pllana, Znj.Olivia Kirtley, Z.Hysen Çela*

## Pjesëmarrja në takimin e Komisionit për Zhvillimin e Organizatave Profesionale

ShKÇAK vazhdon të jetë aktive në zhvillime globale përmes përfaqësimit në Komisionin për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të FNK-së. Gjatë takimit të mbajtur në New York, Drejtoresha Ekzekutive, Znj. Ardiana Bunjaku, prezantoi skemën e certifikimit për Sektorin Publik respektivisht të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Shembulli i ShKÇAK-së për ngritje të kapaciteteve të Sektorit publik në profesion ishte vlerësuar lart nga përfaqësuesit e vendeve anëtare të FNK-së. Skema e certifikimit të ShKÇAK për sektorin publik është publikuar edhe në ueb faqe të FNK-së, në mënyrë që shtetet anëtare të saj të kenë mundësinë ta përdorin si udhëzues për zhvillim të një programi të tillë edhe në vendet e tyre.



*Takimi vjetor i FCM, Porto-Portugali*



*Prezantimi nga Ardiana Bunjaku në takimin e PAODC*

## Përfaqësimi në Federatën e Kontabilistëve të Mesdheut

Në takimin e rregullt vjetor të Federatës së Kontabilistëve të Mesdheut (FCM) të mbajtur në Porto, Portugali, ShKÇAK u përfaqësua nga Z. Shaban Muharremi dhe Znj. Ardiana Bunjaku, e cila është edhe anëtare e bordit ekzekutiv në këtë organizatë. Në këtë takim u shqyrtua dhe u aprovua raporti vjetor, pasqyrat financiare, buxheti si dhe shqyrtimi i kërkesave për anëtarësim të anëtarëve të rinj.



*Kongresi i 71-të i Këshillit të Lartë të Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Francës, Bruksel-Belgjikë*

## **Pjesëmarrja në Kongresin e Institutit të Kontabilistëve dhe Auditorëve të Malit të Zi**

Instituti i Kontabilistëve dhe Auditorëve të Malit të Zi (IRRCG) organizoi Kongresin me rastin e 60 vjetorit të themelimit të saj. Në mesin e të ftuarve ishte edhe ShKÇAK e cila u përfaqësua nga Z. Nazmi Pllana dhe Z. Art Navakazi. Gjatë këtij kongresi, në kuadër të aktiviteteve vlen të veçohet takimi i përfaqësuesve të organizatave profesionale me Presidentin e Malit të Zi, Z. Filip Vujanovic, me ç'rast patën mundësinë të diskutojnë mbi rolin dhe rëndësinë e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në zhvillimin ekonomik. Në fund të ceremonisë, Drejtori i IRRCG u shpërndau mirënjohje për bashkëpunim të gjithë pjesëmarrësve të organizatave profesionale.

Z. Pllana në fjalën e tij të rastit shprehi gatishmërinë e Shoqatës për thellimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm.



*Pjesëmarrja në Kongresin e 60 vjetorit të Institutit të Kontabilistëve dhe Auditorëve të Malit të Zi*

## Pjesëmarrja e ShKÇAK në programin e Bankës Botërore EU-REPARIS

Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar e Bankës Botërore edhe gjatë vitit 2016 vazhdoi me aktivitetet për reformimin dhe ngritjen e besueshmërisë së raportimit financiar në shtetet e Evropës Juglindore dhe Azisë Qendrore. Në këtë drejtim, më 27 prill të vitit 2016 u organizua Konferenca e Ministrave, e 6-ta me radhë në të cilën morën pjesë rreth 240 delegatë përfshirë Ministra të Financave, përfaqësues të lartë të shteteve, përfaqësues të bizneseve dhe përfaqësues të komunitetit profesional dhe akademik nga Evropa dhe Azia Qendrore.

Kosova në këtë ngjarje u përfaqësua nga Z. Avdullah Hoti, Ministër i Financave, Znj. Ardita Dushi nga Ministria e Financave Z. Gem Maloku dhe Z. Mehmet Gjuka nga KKRF si dhe Z. Shaban Muharremi, Znj. Ardiana Bunjaku dhe Z. Arbër Hoti nga ShKÇAK. Konferenca ishte një mundësi për rregullatorët dhe politikbërësit që të diskutojnë lidhur me zhvillimin e profesionit dhe reformimin e raportimit financiar dhe auditimit si dhe rëndësinë që ky profesion ka për ngritjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të një vendi.



*Përfaqësuesit e Kosovës në Konferencën e Ministrave të Bankës Botërore, Vjenë-Austri*

Në prill të këtij viti, në organizimin e forumit mbi organizatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit me temën **“Informatat Financiare: Katalizator për Zhvillim”**, Znj. Bunjaku ishte pjesë e panelit në të cilën u diskutua strategjia e re e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) mbi pajtueshmërinë e anëtarëve me Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë (DOA), e cila strategji tanimë reflekton kalimin nga mbledhja e informatave dhe zhvillimin e planit të veprimit në gjenerimin e analizave kualitative në adoptimin e standardeve si dhe cilësinë e mekanizmave të fuqizimit të atyre standardeve.



*Prezantimi i ShKÇAK në forumin mbi organizatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit të CFRR*

## Trajnimi i Trajnerëve për Auditim dhe Raportim Financiar, në kuadër të programit EU-REPARIS të QRRF

Ligjëruesit e Shoqatës në vazhdimësi kanë qenë pjesë e Trajnimeve për Trajnerë (TT), të cilat organizohen nga Banka Botërore, në kuadër të programit të reformës së kontabilitetit dhe auditimit si dhe fuqizimit institucional EU-REPARIS të Qendrës për Reformimin e Raportimit Financiar (QRRF) të Bankës Botërore.

Gjatë vitit 2016, përfaqësuesit e ShKÇAK kanë qenë pjesë e Trajnimit të Trajnerëve për Auditim së bashku me përfaqësues të tjerë të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit (OPK) të shteteve të rajonit.

Pjesëmarrës në këto trajnim kanë qenë përgjegjësit për krijimin dhe ofrimin e programeve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional për auditorët ligjorë dhe firmat e auditimit ku kanë diskutuar së bashku rreth sfidave të zhvillimit të EVP-ve, burimeve në dispozicion si dhe identifikimit të zgjidhjeve të përbashkëta.

Punëtoritë për TT për Auditimit kanë për qëllim të zhvillojnë kapacitetin e profesionit të auditimit për të organizuar trajnime me cilësi të lartë dhe për të ofruar programe të edukimit të vazhdueshëm profesional bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA).

Punëtoritë përqendrohen veçanërisht në nevojat dhe sfidat e firmave të vogla dhe të mesme të auditimit në implementimin e SNA-ve dhe ndihmojnë që t'i udhëzojnë auditorët në zhvillimin e procedurave të sigurimit të cilësisë në nivel të firmës dhe angazhimeve.



*Pjesëmarrja në Trajnimin e Trajnerëve EU-REPARIS, QRRF e Bankës Botërore*

Ndërsa punëtoritë e organizuara për raportim financiar për NVM, të organizuara në shkurt dhe mars të vitit 2016, kishin për qëllim që të gjithë trajnerët pjesëmarrës të njoftohen mbi implementimin e amendamenteve të reja të SNRF për NVM si dhe zhvillimin e aftësive për të gjykuar kur duhet zbatuar ky standard.

Njohuritë mbi SNA-të dhe SNRF-të të reja dhe të ndryshuara për NVM-të si dhe praktikat më të mira për zhvillimin e ofrimin e programeve të EVP-së për auditim dhe raportim financiar, reflektohen gjatë organizimit të trajnimeve të rregullta të programeve certifikuese të ShKÇAK si dhe EVP-ve për anëtarët të saj.

### **Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar organizon punëtori për palët e ndërlidhura për raportim financiar dhe auditim**

Në kuadër të programit të Qendrës për Reformimin e Raportimit Financiar (QRRF), gjatë vitit 2016 është organizuar punëtorja me temën “Informatat financiare të NVM-ve, katalizator për huamarrje bankare”. Kjo punëtori përveç përfaqësuesve të organizatave profesionale mbledhi edhe përfaqësuesit e rregullatorëve dhe institucioneve tjera relevante të cilët janë përgjegjës për implementimin e mirëfilltë të raportimit financiar dhe auditimit. Kosova u përfaqësua nga Znj. Ardiana Bunjaku dhe Z. Arbër Hoti, ShKÇAK, Z. Mehmet Gjuka, KKRF, Z. Gazmend Mejzini, ARBK.

Në këtë punëtori u diskutua se si raportimi financiar, auditimi dhe shërbimet tjera këshilluese nga profesionit mund të rrisin potencialin e NVM-ve, duke u siguruar menaxherëve dhe pronarëve të kompanive informacionet e duhura për identifikimin dhe adresimin e sfidave financiare për menaxhimin e kompanive të tyre. Zhvillimi i shërbimeve profesionale për NVM-të dhe asistimi i tyre në proceset financiare është mekanizmi kryesor për rritje ekonomike në shtetet e Evropës. Kjo gjithashtu mund të krijojë klimë më të mirë biznesore dhe të investimeve, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritje të qëndrueshme.



## Implementimi i programit të përbashkët të certifikimit ShKÇAK-CIPFA

Në kuadër të implementimit të marrëveshjes për zhvillimin e programit të certifikimit në Menaxhimin e Financave Publike, ShKÇAK dhe CIPFA kanë organizuar Trajnimin e Trajnerëve për qëllim të ngritjes së kapaciteteve të ligjëruesve të Shoqatës në Raportimin Financiar të Sektorit Publik dhe Financave Publike.

Trajnimi është mbajtur në Prishtinë ku pas përfundimit të këtij trajnimi, Shoqata krijoi kapacitete të mjaftueshme për të mbuluar tërë programin certifikues nga ligjëruesit vendor gjë që demonstroi edhe një herë që ShKÇAK përmbushë strategjinë e saj për qëndrueshmërinë e programit të edukimit.



## Zhvillimi i sistemit të kontrollit të cilësisë edhe për kontabilistët, anëtarë të Shoqatës

Një nga pikat e rëndësishme të strategjisë së punës së Shoqatës është zhvillimi dhe implementimi i sistemit të kontrollit të cilësisë për kontabilistët dhe auditorët në Kosovë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare dhe Direktivat e BE-së. Me zhvillimin e Departamentit të kontrollit të cilësisë si dhe zhvillimit të procesit dhe procedurave për implementimin e DOA 1 (SMO 1) për kontrollin e cilësisë së auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore, është parë e nevojshme që ShKÇAK të fillojë hulumtimin rreth gjetjes së praktikave më të mira nga organizatat profesionale të zhvilluara për kontrollin e cilësisë së punës edhe të kontabilistëve. Në këtë drejtim, përfaqësuesit e Shoqatës morën pjesë në punëtorinë dy-ditore të organizuar nga Instituti i Auditorëve të Çertifikuar të Anglisë dhe Uells-it (ICAEW) në Beograd, ku u prezantua metodologjia e punës shumëvjeçare të ICAEW në kontrollin e cilësisë së punës së kontabilistëve të tyre.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin shoqatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit nga Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia, ndërsa qëllimi i organizimit të saj ishte që ICAEW të ndihmojë shoqatat e rajonit të krijojnë një skemë funksionale dhe efektive të kontrollit të cilësisë për punën e kontabilistëve të çertifikuar të cilët ofrojnë shërbime të kontabilitetit, tatimeve dhe shërbime të tjera ndaj publikut të gjerë.

## Avancimi i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit përmes bashkëpunimit me palët e tjera të interesit

ShKÇAK gjithnjë duke u bazuar në ekspertizën e vet profesionale dhe si anëtare me të drejta të plota në FNK dhe duke qenë e bindur se ndërtimi i një infrastrukture të qëndrueshme ligjore si dhe zbatimi i plotë i saj ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit, në vazhdimësi kontribuon në inicimin e ndryshimit të legjislacionit vendor në mënyrë që të sigurojë që politikat e zhvillimit të profesionit janë në harmoni me standardet e përcaktuara nga ligjvënësit ndërkombëtar. Gjatë vitit 2016, ShKÇAK ka iniciuar debate me palët e interesit për Ligjin Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për plotësimin e zbrazëtirave dhe eliminimin e mangësive që janë në këtë ligj. Në këtë drejtim, Shoqata ka hartuar rekomandimet e saj lidhur me përafrimin e këtij ligji me kërkesat e Direktivës së BE-së dhe praktikave më të mira të cilat janë të zbatueshme në Kosovë. Këto rekomandime që në vete përmbajnë 24 pika kyçe, iu kanë drejtuar të gjitha Institucioneve relevante në Kosovë dhe jashtë vendit.

ShKÇAK do të jetë këmbëngulëse në implementimin e këtyre rekomandimeve duke kthyer besueshmërinë në raportimin financiar me qëllim të krijimit të një ambienti të besueshëm për investime i cila do të ndikojë në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme të vendit.

Për këtë qëllim, ShKÇAK ishte pjesë aktive e grupit punues të MTI për implementimin e MSA. Duke pasur parasysh se implementimi i reformës fiskale dhe ngritja e cilësisë së raportimit financiar janë kriteret të përcaktuara nga Bashkimi Evropian për vendet që synojnë anëtarësimin në familjen evropiane, Shoqata është angazhuar si pjesë e grupit punues që nga fillimi i negociatave për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit-MSA. Gjatë këtij viti përveç kontributit të saj të dhënë në këtë drejtim, përfaqësuesit e Shoqatës kanë marrë pjesë në seminarin "Direktiva e shërbimeve 123/2006, shqyrtimi i legjislacionit në Kosovë", organizuar nga projekti "Asistenca për Implementimin e MSA-së - Direktiva e BE-së për Shërbimet" dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Me qëllim që të jetë sa më afër zhvillimeve dhe të ushtrojë ndikimin e vet në përmirësimin e kushteve të të bërit biznes e të cilat lidhen drejtpërdrejt me profesionin, Shoqata vazhdon të jetë anëtare aktive në Zyrën e Komunitetit të Bizneseve pranë Kuvendit të Kosovës si dhe Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë. Gjatë këtij viti, ShKÇAK ka dhënë kontributin e saj përmes komentimit të projektligjeve dhe ligjeve, si në: Ligjin për Sigurimin Shëndetësor, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjet Tatimore, e kështu me radhë.



*Pjesëmarrja në seminarin "Asistenca për Implementimin e MSA-së - Direktiva e BE-së për Shërbimet"*



*ShKÇAK pjesë e Zyrës së Komunitetit të Bizneseve pranë Kuvendit të Kosovës*

## **Përbushja e kërkesave që dalin nga Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit**

Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, i përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit si dhe specifikon obligimet ligjore të kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve dhe gjithashtu parasheh edhe inspektimin dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me ligjin si dhe tipologjitë dhe treguesit e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në këtë drejtim, ShKÇAK dhe Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës (NJIFK) organizuan çertifikimin e parë në Kosovë për të përbushur kërkesat që dalin nga ky ligj.

Kontabilistët dhe auditorët si akterë të angazhuar në institucionet e sektorit publik dhe atij privat, janë të përkushtuar që me profesionalizmin e tyre të luftojnë çfarëdo dukurie të ekonomisë joformale dhe tendenca tjera që mund të shkaktojnë pengesa në zhvillim ekonomik.



*Trajnimi i organizuar nga ShKÇAK dhe NJIFK*

## NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE – SHTYLLË KYÇE E SHKÇAK

Shoqata edhe në vitin 2016 ka qenë e përkushtuar në ofrimin e edukimit cilësor për ngritjen e kapaciteteve profesionale në vend, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE).

Njohuritë për Standardet më të avancuara të kontabilitetit, auditimit, etikës profesionale të ofruara nga ligjëruesit me përvojë shumë vjeçare, kanë ndikuar që programi çertifikues i ShKÇAK të jetë edhe më atraktiv për të gjithë ata që synojnë të zhvillojnë karrierën në këtë profesion.

Shoqata ka azhurnuar të gjitha materialet konform ndryshimeve në standardet ndërkombëtare dhe bazuar në marrëveshjen me BPP Learning Media. Në bashkëpunim me Deloitte Kosova është azhurnuar libri mbi legjislacionin vendor për të reflektuar kështu ndryshimet e bëra gjatë vitit 2016 dhe për t'iu mundësuar anëtarëve që të jenë në hap me ndryshimet më të reja në profesion.

Përkushtimi i Shoqatës në implementimin e standardeve më të larta të edukimit dhe zbatimi i kriterëve ka rezultuar në besueshmërinë dhe reputacionin e lartë që ShKÇAK e mbanë që nga themelimi i saj, si rrjedhojë interesimi për regjistrim në programin çertifikues të ShKÇAK ka shënuar rritje të vazhdueshme ku gjatë vitit 2016 numri i të regjistruarve ka arritur rreth 500 studentë të rinj.

Viti 2016 u shënuar gjithashtu edhe me çertifikimin e 100 auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Çertifikimi i auditorëve të ZKA është i pari i këtij lloji dhe rezultoi me një organizim solemn në të cilën morën pjesë krerët më të lartë të shtetit, Presidenti i Republikës së Kosovës, Z. Hashim Thaçi, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe publike të vendit si dhe përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi.



*Cermonia e Çertifikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit*




*Cermonia e Çertifikimit të fundvitit*

## Çertifikimi i Auditorëve të Brendshëm – Objektivë e ShKÇAK

Strategjia e ShKÇAK për vitin 2015-2019 ka parashikuar investimin në zhvillimin e programit çertifikues për Auditor të Brendshëm. Gjatë këtij viti, Shoqata ka nënshkruar marrëveshjen e të drejtës ekskluzive për përkthimin dhe përdorimin e materialeve të Wiley, botues i aprovuar nga Instituti Ndërkombëtar për Auditim të Brendshëm (IIA). Në të njëjtën kohë, ShKÇAK ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e implementimit të programit çertifikues i cili do të ofrohet nga viti 2017.

Çertifikimi i Auditorëve të Brendshëm është parë si një domosdoshmëri për ngritjen e kapaciteteve si në sektorin publik po ashtu edhe në atë privat. Në këtë drejtim, ShKÇAK është duke zhvilluar bashkëpunime me organizata rajonale dhe ato ndërkombëtare, në mënyrë që të ofroj anëtarëve të saj, të interesuar për këtë certifikim praktikatat më të mira, si dhe njohje ndërkombëtare.



## Përvetësimi i njohurive përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional

Shoqata i ka dhënë një fokus të veçantë Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, proces ky i domosdoshëm për mirëmbajtje të cilësisë profesionale.



Përfundimi i suksesshëm i trajnimeve dhe çertifikimi në programet e shumta që ofrohen për sektorin privat dhe atë publik, për një anëtar të ShKÇAK-së nuk nënkupton edhe mbarimin e edukimit profesional. Duke qenë pjesë e Shoqatës, anëtarët në vazhdimësi përfitojnë nga trajnimet që organizohen në kuadër të EVP-ve, të cilat u ndihmojnë atyre të mirëmbajnë përgjegjësinë profesionale, përvetësojnë praktikën e punës dhe të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime sa më cilësore, gjë që përmbush edhe pritjet e klientëve të tyre.



Prandaj, ShKÇAK, në vazhdimësi harton programe për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të anëtarëve të saj, të cilat janë në hap me azhurnimet e standardeve të lëshuara nga standard-vënësit ndërkombëtarë dhe vendor. Me azhurnimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, të cilat janë përkthyer nga ShKÇAK dhe me që implementimi i tyre pritet të bëhet gjatë vitit 2017, Shoqata ka organizuar sesione të EVP, në mënyrë që anëtarët e saj të jenë të gatshëm për implementimin e tyre.

Për të qenë gjithmonë afër anëtarëve të saj, Shoqata ka organizuar sesione të EVP-ve edhe sipas kërkesave të anëtarëve, duke iu ofruar mundësi që të përzgjedhin temat të cilat anëtarët i kanë konsideruar si relevante dhe me interes për profesionin e tyre.



Gjatë vitit 2016, ShKÇAK ka realizuar 64 orë të EVP-ve, me temat: Kontabiliteti tatimor VS Kontabiliteti financiar – Ndërtimtaria, Raportimi financiar në bazë të kërkesave të ligjit dhe udhëzimeve administrative, SNK 17 Lizingu dhe përmbledhje e ndryshimeve në Standardin e ri SNRF 16 për Lizingun, Roli i kontabilitetit dhe auditimit në mbrojtje të interesit publik, Auditimi i brendshëm i institucioneve financiare, SNA 700 (rishikuar) - Formimi i opinionit dhe raportimi mbi pasqyrat financiare, SNA 701 (standard i ri) - Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit dhe Kodi i etikës, Raportimi Financiar në sektorin publik, Të hyrët dhe shpenzimet publike, Kostot e specializuara dhe teknikat e kontabilitetit të menaxhimit, Obligimet ligjore të Kontabilistëve dhe Auditorëve sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT, SNA 570 – Parimi i vazhdimësisë SNA 260 – Komunikimi me palët e angazhuara në qeverisje, SNA 520 – Procedurat analitike.

## SHËRBIMI DHE KOMUNIKIMI ME ANËTARË- OBJEKTIVË E PËRHERSHME E SHOQATËS

Besueshmëria në vlerën e edukimit dhe cilësia e shërbimeve që ofrohen nga Shoqata, ka bërë që numri i anëtarëve të saj në vazhdimësi të rritet dhe sot ShKÇAK numëron rreth 7000 anëtarë të angazhuar në sektorë të ndryshëm privat dhe publik brenda Republikës së Kosovës.

Digjitalizimi i mjeteve të komunikimit dhe shtrirja e përdorimit të rrjeteve sociale si mjete komunikimi, ka mundësuar që ShKÇAK të jetë sa më afër anëtarëve të saj, duke i informuar me kohë për zhvillimet e reja në lidhje me profesionin e kontabilitetit dhe auditmit, për plotësimet dhe ndryshimet e standardeve të lëshuara nga standard-vënësit në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Fokus të veçantë gjatë këtij viti, Shoqata i ka dhënë edhe krijimit të pyetësorëve si një mjet komunikimi me anëtarët e saj, përmes të cilëve anëtarët i kanë shprehur opinionet e tyre për çështjet aktuale lidhur me zhvillimet e profesionit si dhe vetë Shoqatës.

Përveç komunikimit elektronik, shërbimi për anëtarë është përkujdesur që në agjendën e saj të vë në rend të parë anëtarët dhe zhvillimin e tyre. Në këtë drejtim janë organizuar një sërë vizitash me qëllim që atyre t'ju ofrohet mundësia për t'i paraqitur më për së afërmi pengesat që ata hasin gjatë punës së tyre. Kjo do ta ndihmojë Shoqatën që të kuptojë dhe në të njëjtën kohë të bëjë përpjekje që të ndikojë në përmirësimin e ambientit dhe krijimin e kushteve më të mira, duke përdorur ndikimin e saj në institucionet kompetente.



## Studentët e dalluar për vitin 2016

Me qëllim të motivimit dhe inkurajimit për të arritur rezultate sa më të mira, ShKÇAK gjatë ceremonisë së fundvitit ka shpallur tre studentë të dalluar për vitin 2016.



*Genc Gigollaj,  
Student i dalluar i nivelit  
Auditor i Çertifikuar*

*Fitim Sahiti,  
Student i dalluar i nivelit  
Kontabilist i Çertifikuar*



*Besjana Desipojci,  
Studente e dalluar e nivelit  
Teknik i Kontabilitetit*







15

VJET  
YEARS

## Raportet nga Komisionet

Një ndër faktorët me rëndësi që ndikojnë në punën e mirë të Shoqatës janë edhe Komisionet, të cilat përkujdesen që strategjia e veprimit të ShKÇAK-së, të zbatohet në përpikëri.

Funksion parësor i Komisioneve të Shoqatës është angazhimi në realizimin e objektivave të parashtruara nga Shoqata dhe veprimi në pajtim me Deklaratën e Obligimeve të Anëtarësisë së FNK.

Qëllimi i angazhimit të anëtarëve të Komisioneve është sigurimi i shërbimeve cilësore në të mirë të interesit publik, garantimit të rolit përfaqësues të ShKÇAK, rolit në përcaktimin e standardeve profesionale të edukimit, respektimin e kodit të etikës nga profesionistët e kontabilitetit dhe ruajtjen e integritetit profesional, implementimin e standardeve ndërkombëtare të profesionistëve të kontabilitetit në sektorin publik.

Komisionet e Shoqatës kanë role aktive edhe në iniciimin e hartimit të akteve normative me qëllim të avansimit të profesionit dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për një zhvillim të mirëfilltë profesional të kontabilistëve dhe auditorëve.



*Këshilli, Komisionet dhe Zyra Ekzekutive*



## Raport nga Komisioni për Nominime

Të nderuar anëtarë,

Përfaqësimi juaj në strukturat e Shoqatës dhe pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet që zhvillohen brenda saj, informimi me kohë dhe mbi të gjitha zëri juaj, realizohet përmes anëtarëve për të cilët ju votoni. Zgjedhja e përfaqësuesve tuaj është e drejtë ekskluzive e juaja, është e drejtë e arritur me punën dhe angazhimin tuaj për vite me radhë.

Për të qenë në hap me të arriturat e Shoqatës dhe për të vazhduar me këtë trend pozitiv, gjithnjë është e nevojshme përfshirja sa më e madhe anëtarëve në zhvillimet e Shoqatës e sidomos përmes pjesëmarrjes sa më të madhe në Mbledhjet e përgjithshme të Asamblesë, ku ju do të informoheni më për së afërmi me planin dhe strategjinë e zhvillimit e që në pjesë të madhe do të jenë edhe determinuese për votën tuaj. Në çdo vit zgjedhor, duke filluar nga procesi i nominimit deri tek votimi, Komisioni i Nominimeve është shumë i përkushtuar që me përpikëri të zbatoj kërkesat që dalin nga Statuti, Rregullorja e komisionit dhe dokumentet tjera relevante të Shoqatës dhe duke u mbështetur në parimin e transparencës dhe objektivitetit. Viti 2016 ka qenë vit zgjedhor për Shoqatën dhe për ta realizuar tërë procesin zgjedhor në kohë të mjaftueshme para Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë, Komisioni i Nominimeve ka filluar me përgatitjet për këtë proces qysh në muajin shkurt 2016.

Gjatë tërë procesit zgjedhor, Komisioni i Nominimeve është përkushtuar që të respektohen të gjitha afatet e përcaktuara me planin e punës së Komisionit dhe me Rregulloren e Komisionit. Brenda këtyre afateve që nga shpallja e ftesës për nominime, ju anëtarë të nderuar, keni pasur mundësinë që të nominoni anëtarët, kolegë tuaj për Këshill dhe për Komisionin për Sjellje dhe Disiplinë, dy organe të rëndësishme të Shoqatës të cilat për mandatin e tyre do t'i realizojnë objektivat të cilat ju i keni përcaktuar me Statut por edhe me strategjinë e miratuar nga ju.

Të gjitha nominimet e pranuar, 25 për anëtarë të Këshillit dhe 14 për Komision për Sjellje dhe Disiplinë, janë shqyrtuar nga Komisioni i Nominimeve konform kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara me Statut, Rregulloren e Komisionit dhe Ftesën për Nominime. Anëtarët e nominuar të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara janë ftuar në intervistim nga Komisioni ku ata i kanë paraqitur pikëpamjet dhe idetë e tyre për mënyrën se si do ta realizojnë kontributin e tyre në këto organe.

Intervistimi i anëtarëve të nominuar i ka paraprirë përgatitjes së rekomandimeve dhe listës përfundimtare të nominuarve e cila është prezantuar para anëtarëve të Asamblesë në Mbledhjen e Përgjithshme 2016. Në këtë Mbledhje, nga anëtarët e nominuar me votën tuaj ua keni dhënë besimin anëtarëve për, Këshillin e Shoqatës i cili për dy vitet e ardhshme në emrin tuaj do ta udhëheq Shoqatën si dhe keni zgjedhur Komisionin Disiplinor i cili gjatë mandatit të ardhshëm 3 vjeçar do të përkujdeset që në kuadër të kompetencave të mbroj vlerat e arritura të profesionit dhe Shoqatës duke u mbështetur në Statut, Rregullore të Komisionit dhe Kodin e Etikës profesionale.

Prandaj, jo vetëm në këto organe të Shoqatës por edhe në të gjitha organet tjera është i shprehur vullneti i juaj i lirë, dëshira e juaj që të arrihen objektivat e përcaktuara dhe qëllimi i përbashkët që dhe ti ruajmë dhe avancojmë vlerat e arritura me përkushtim të madh dhe etikë profesionale.

### **Nazmi Pllana** **Kryesues i Komisionit për Nominime**



*Nga e majta: Fahri Breznica, Naim Avdiu, Burim Zagragja, Adrian Alo, Shaban Muharremi, Nazmi Pllana, Tomorr Zhaveli*



## Raport nga Komisioni për Edukim Profesional

Të nderuar anëtarë,

Puna e komisionit për vitin 2016 është bazuar në planin strategjik të ShKÇAK, ku ndër prioritetet më të larta përfshihet inkorporimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit (SNE) dhe udhëzimeve të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në Kontabilitet (BSNEK), në të gjitha programet e certifikimit të ShKÇAK, duke u fokusuar edhe në sektorët specifik si ai publik dhe auditimi i brendshëm si pika kyçe të Strategjisë 2015-2019.

### Zhvillimi i programit certifikues për Auditor të Brendshëm

Komision në bashkëpunim me Zyrën Ekzekutive dhe Këshillin e Shoqatës kanë punuar në zhvillimin e programit të certifikimit për Auditor të Brendshëm, i cili ofrohet për herë të parë në Kosovë duke u mbështetur në materialet e Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA, me bazë në Amerikë), me të cilët Shoqata ka arritur të krijojë marrëveshje.

Në këtë drejtim, Komisioni detajisht ka shqyrtuar kërkesat për kandidatët të cilët do të fitojnë titullin si Auditor i Brendshëm i Çertifikuar, duke përfshirë kërkesat për shkollimin universitar, edukimin profesional si dhe kërkesat e përvojës praktike.

Çertifikimi përfshin tre lëndë:

- B1/Elementet e njohurive të Auditimit të Brendshëm
- B2/Bazat e Auditimit të Brendshëm
- B3/Praktika e Auditimit të Brendshëm

Për më tepër anëtarët të cilët janë të interesuar për zhvillim të karrierës si Auditor i Brendshëm gjatë programit do të kenë mundësi të fitojnë njohuri nga lënda B1/Elementet e njohurive nga Auditimi i Brendshëm i cili ka një gjithpërfshirje të temave nga

informative e të cilat janë të nevojshme për një auditor të brendshëm. Ndërsa temat të cilat përfshihen në lëndën e dytë dhe të tretë janë ekskluzivisht të përqendruara në punën e auditorit të brendshëm dhe zbatimin adekuat të standardeve të auditimit të brendshëm. Literatura si dhe materialet përcjellëse të programit certifikues janë nga Wiley, botues i aprovuar nga IIA.

Duke u bazuar në përmbajtjen e materialit të lëndës B1 komisioni ka propozuar dhe e njëjta është aprovuar nga Këshilli i ShKÇAK që anëtarët ekzistues të Shoqatës të cilët e kanë titullin Kontabilist i Çertifikuar ose Auditor i Çertifikuar do të fitojnë titullin Auditor i Brendshëm i Çertifikuar pas përfundimit të lëndëve B2 dhe B3 si dhe përmbushjes së përvojës praktike relevante.

Procesi i ligjëratave dhe provimeve do të realizohen në pajtueshmëri me procedurat e brendshme të aprovuara të ShKÇAK të cilat do të sigurojnë arritjen e rezultateve cilësore në ofrimin e këtij programi. Gjithashtu Komisioni ka dhënë rekomandimet e veta edhe sa i përket Kontrollit të Cilësisë së Auditorëve të Brendshëm, ku në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit të Brendshëm Nr. 1300 – 'Programi i Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë', vlerësimi i jashtëm i kontrollit të cilësisë duhet të bëhet së paku një herë në pesë vite. Vlerësimi i jashtëm duhet të bëhet nga një vlerësues i pavarur dhe i kualifikuar ose nga një ekip vlerësimi.

Së paku një herë në pesë vite anëtari i ShKÇAK i cili mbanë thirrjen Auditor i Brendshëm i Çertifikuar dhe i cili e praktikon profesionin e auditimit të brendshëm, duhet të sjellë një kopje të raportit të vlerësimit, si një nga kushtet për vazhdimin e anëtarësisë.

### Akreditimi i programeve të certifikimit nga AKK

Gjatë vitit 2016, Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e detajuar të përgatitur nga Zyra Ekzekutive për akreditimin e programeve certifikuese në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK). Përpos Raportit të Vetëvlerësimit dhe Aplikacioneve të cilat janë plotësuar, janë dërguar edhe planprogramet e detajuara për secilën lëndë veç e veç e që në total janë 29 lëndë, duke përfshirë objektivat e kapitujve dhe rezultatet e synuara për t'u arritur nga kandidatët. Në kuadër të plotësimit të dokumentacionit janë përfshirë edhe procedurat e detajuara të vlerësimit të kandidatëve dhe të sistemit të provimeve.

AKK pas një procesi të gjatë të mbikëqyrjes ka akredituar të gjitha thirrjet e programeve certifikuese si në sektorin privat po ashtu edhe në atë publik duke përfshirë edhe programin certifikues për Auditor të Brendshëm.

Shoqata ka pranuar komente pozitive nga AKK për përgatitjen e dokumentacionit si dhe implementimin e procedurave në praktikë. Për të cilën gjë ne si Komision i Edukimit e falënderojmë Zyrën Ekzekutive për një punë dhe dedikim të madh që kanë treguar.

### Zhvillim i mëtutjeshëm në drejtim të bashkëpunimit me Universitete

Edhe pse fokusi kryesor ishte në zhvillimin e programit certifikues për Auditor të Brendshëm dhe Akreditimit, Komisioni i Edukimit ka vazhduar bashkëpunimin me universitetet në Kosovë, ku ndër të tjera është punuar në përcaktimin e kushteve dhe procedurave për mbikëqyrje të implementimit të programeve për kontabilitet në këto universitete, si dhe janë nënshkruar marrëveshje të reja me universitete, si me universitetin publik "Haxhi Zeka" në Pejë. Me këtë Universitet është punuar ngushtë që të përfshihen pjesët e plan-programit të Shoqatës të cilat nuk mbulohen nga edukimi universitar për lëndët e kontabilitetit, si dhe janë inkorporuar pjesët e materialeve të ShKÇAK në materialet e ofruara për studentët e këtij universiteti.

E tërë kjo me qëllim për të siguruar se standardet dhe publikimet e bordeve ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit, auditimit, menaxhmentit financiar dhe etikës, përfaqësojnë një pikë orientimi për profesionin në Kosovë gjë që do të ndihmojë në krijimin e gjeneratave të reja të profesionistëve kompetent në tregun e punës.

### Edukimi i vazhdueshëm profesional – në hap me trende globale

Duke pas parasysh se Shoqata ka synim primar sigurimin e azhurnimit të anëtarëve me të gjitha zhvillimet e reja, ajo përkujdeset për të ofruar një llojllojshmëri të sesioneve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në lëmin e raportimit financiar, auditimit, menaxhmentit financiar dhe tatimeve. Komisioni për Edukim Profesional është kujdesur që edhe këtë vit të përcakton planin e EVP-ve si dhe të sigurohet implementimi i këtij plani për vitin 2016. Gjatë përgatitjes së planit të EVP çdo herë ky Komision është përkujdesur ti marrë parasysh kërkesat e anëtarësisë të drejtuara në Departamentin e Shërbimit për Anëtarë si dhe përmes anketimit online, por në të njëjtën kohë është përkujdesur edhe për azhurnimin me ndryshimet me të

fundit të standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga standard-vënësit global.

### Fokus në njohje ndërkombëtare

Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare edhe gjatë këtij viti Komisioni është fokusuar në komponentën e njohjes reciproke të programit të edukimit, ku përveç thellimit të bashkëpunimit me ACCA dhe CIPFA, gjatë këtij viti ShKÇAK ka arritur edhe një marrëveshje për njohje me Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar (AAT, me bazë në Britaninë e Madhe).

Komisioni së bashku me Departamentin Profesional vazhdon të jetë aktiv në komentimin e propozimeve të lëshuara nga FNK dhe BE në fushën e edukimit profesional dhe të mbajë lidhje me organizatat relevante si brenda Kosovës gjithashtu ato ndërkombëtare për të siguruar se programi i ShKÇAK mbetet i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës dhe i njohur jashtë Kosovës.

Me reputacionin e lartë që ka arritur Shoqata falë punës së palodhshme të të gjithëve të involvuar në procesin e edukimit dhe trajnimit, vazhdon edhe pas pesëmbëdhjetë viteve të punës së saj të jetë lidere në ofrimin e programeve të certifikimit për kontabilitet dhe auditim. Bazuar në këtë, Ne si Komision jo vetëm që kemi përgjegjësi profesionale por edhe morale që të bëjmë përpjekjet tona maksimale, që në vazhdimësi ti kushtohet vëmendje dhe rëndësi e veçantë komponentës së edukimit profesional si pjesë për zhvillimin e kapaciteteve në kontabilitet dhe auditim.

### Naim Avdiu

Kryesues i Komisionit për Edukim Profesional



Nga e majta: Naim Avdiu, Edona Perjuci-Uka, Lulzim Zeka, mungon Visar Peci, Riza Spanca



## Raport nga Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë

Të nderuar Anëtarë,

Respektimi i Kodit të Etikës, standardeve me të larta dhe profesionalizmi i anëtarëve të ShKÇAK, është virtyti me të cilin identifikohet Shoqata si tërësi por edhe anëtarët si individë.

Përkushtimi i anëtarëve në promovimin dhe avancimin e vlerave të arritura e kanë mirëmbajtur vazhdimisht imazhin e Shoqatës si brenda vendit e po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

Parimet themelore të Kodit të Etikës janë udhërrëfyes për secilin anëtar gjatë angazhimit të tij e respektimi i këtyre parimeve, së pari Shoqatën por edhe ne si Komision për Sjellje dhe Disiplinë na bën të ndihemi mirë pasi që nuk mund ta fshehim kënaqësinë që nuk kemi pasur asnjë rast të raportuar për shkelje.

Kjo assesi nuk nënkupton se Komisioni Për sjellje dhe Disiplinë është i kënaqur që nuk ka punë dhe angazhim, pasi që fushë veprimtaria e këtij komisioni nuk e ka prioritet vetëm ndëshkimin e atyre që bëjnë shkelje por përveç kësaj ka për qëllim edhe informimin e vazhdueshëm të anëtarëve për të rejtat që ndërlidhen me Kodin e Etikës dhe zbatimin e tij konsekuent gjatë punës së tyre.

Megjithatë, Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë e ka mandatin që përmes votës që ia keni dhënë ju, së pari të përkujdeset për mbrojtjen e interesave të Shoqatës, profesionit dhe mbi të gjitha të interesit publik.

Prandaj, Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë ju bënë thirrje që pa asnjë hezitim të raportoni rastet të cilat cilësohen të jenë shkelje sepse çdo raportim i kësaj natyre është mbrojtje e interesave tuaja.

**Aurora Sinanaj-Dinaj**

**Kryesuese e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë**



*Nga e majta: Yll Fondaj, Nazmi Sahitaj, Aurora Sinanaj-Dinaj,  
Arlind Sadria, mungon Shyqiri Bytyqi*



## Raport nga Nën-Komisioni për Tatime

Nën-Komisioni për Tatime është pjesë e organizimit brenda ShKÇAK-së dhe funksionon në kuadër të Komisionit për Edukim Profesional.

Aktiviteti i këtij Nën-Komisioni, si edhe deri më tani, ishte i përqendruar në sferën e ligjeve tatimore që tangojnë anëtarësinë tonë. Zgjidhjet sistemore dhe qartësia e ligjeve tatimore gjithnjë kanë shënuar lëvizje pozitive, por ende mbetet shumë për të bërë. Jeta biznesore edhe qet momente të reja për të cilat duhet angazhim dhe përkushtim për të shtyrë propozime gjithnjë e më të mira, në funksion të punës më të mirë dhe më të suksesshme.

Në vitin 2016 nuk ka pasur ndryshime në ligjet dhe udhëzimet tatimore, me ndonjë përjashtim të vogël, por ne kemi qenë në angazhim të vazhdueshëm që bashkë me Zyrën Ekzekutive të Shoqatës t'i informojmë anëtarët për të rejat në këtë lëmi dhe duke i inkurajuar anëtarët që të japin propozimet e tyre.

Në qershor, Nën-Komisioni ka trajtuar Ligjin për Agjencinë e Tatimeve dhe të Doganës së Kosovës dhe kemi përcjellur 24 rekomandime.

Në shtator është mbajtur mbledhja konstituive e përbërjes aktuale të Nën-Komisionit të Tatimeve.

Në shtator Nën-Komisioni ka shqyrtuar online projekt-udhëzimin administrativ për transferin e çmimeve dhe ka dërguar disa komente.

Në nëntor Kryesuesi i Nën-Komisionit ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Tatimor të OEA ku është shqyrtuar tema “Bordi i Pavarur për Rishqyrtime: Domosdoshmëria dhe Kundërshtimet”.

Në dhjetor Kryesuesi i Nën-Komisionit ka marrë pjesë në sesionin informativ në Odën Ekonomike Amerikane për Ligjin për kamatë-vonesat të prezantuar nga MTI.

Në këtë vit jemi angazhuar të gjejmë forma dhe modalitete të pranueshme, që do të mund të ishim edhe më afër anëtarëve tanë në preokupimet e tyre në ushtrimin e profesionit.

Edhe në vitin aktual do të vazhdojmë të jemi në ngjarje me ndryshimet në sferën tatimore dhe të japim kontributin tonë, gjithnjë në shërbim të anëtarëve tonë dhe të profesionit.

### *Burim Zagragja*

#### *Kryesues i Nën-Komisionit për Tatime*



*Nga e majta: Tomorr Zhaveli, Fahri Breznica, Burim Zagragja, Arbër Hoti mungojnë Sakip Imeri, Xhemail Sylja*



## Raport nga Komisioni për Kontroll të Cilësisë

Të nderuar Anëtarë,

Roli i kontrollit të cilësisë padyshim është një shtyllë tejet e rëndësishme për ngritjen e cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë dhe në ngritjen e besueshmërisë së investitorëve, kreditorëve dhe palëve tjera të interesit në pasqyrat financiare të audituara. Detyrë e këtij komisioni është që të implementojë një sistem të mirëfilltë të kontrollit të cilësisë në mënyrë që të arrihet mbrojtja e interesit publik. Qëllimi kryesor i Komisionit dhe departamentit të Sigurimit të Cilësisë gjatë vitit 2016 ishte përpilimi i rregullores së kontrollit të cilësisë, letrave të punës të cilat do të shfrytëzohen gjatë procesit të kontrollit të cilësisë si dhe hulumtimi i cilësisë së pasqyrave financiare të audituara dhe opinioneve të auditimit, gjithnjë duke u bazuar në planin strategjik dhe planin e punës së ShKÇAK.

Në këtë drejtim si prioritet tjetër i këtij komisionit dhe departamentit të KC gjatë vitit 2016 ishte edhe bashkëpunimi i ndërsjellë me komisionin e sigurimit të cilësisë të KKRF-së për të rishikuar mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy komisioneve në mënyrë që mbikëqyrja publike e auditorëve dhe firmave të ligjore të auditimit të jetë sa më efikase dhe efektive dhe të prodhojë rezultate konkrete në ngritjen e cilësisë së këtij profesioni.

Duke u bazuar në faktin që auditorët ligjor dhe firmat ligjore të auditimit janë profesionistë të pavarur, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-014 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe duke vlerësuar rolin dhe kontributin e tyre në mbrojtje të interesit publik, nëpërmjet zbatimit të drejtë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) dhe respektimit të kërkesave të cilat dalin nga Kodi i Etikës për Auditorët Profesionistë të FNK-së me rekomandim të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë gjatë vitit 2016-të Këshilli i ShKÇAK miratoi rregulloren e kontrollit të cilësisë së punës së auditorëve. Kjo rregullore do të jetë udhërrëfyes për një implementim sa më efektiv të sistemi të kontrollit të cilësisë nga ana e ShKÇAK.

Gjithashtu, komisioni aprovoi edhe letrat e punës që departamenti i kontrollit të cilësisë do ti aplikoj gjatë kryerjes së kontrollit të cilësisë. Për të parë se cila është cilësia e raportimit financiar dhe auditimit të pasqyrave financiare, Departamenti i Kontrollit të Cilësisë në bashkëpunim me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë gjatë vitit 2016-të ka bërë rishikimin e cilësisë së pasqyrave financiare të audituara të ndërmarrjeve të mëdha të cilat kanë pasur obligim dorëzimin e tyre për publikim në KKRF. Qëllimi i kësaj analize ishte që të analizohet nëse pasqyrat financiare të ndërmarrjeve të mëdha janë në pajtueshmëri me kërkesat e SNRF/SNK, si dhe nëse raporti i auditorit është në pajtueshmëri me kërkesat e SNA. Raporti i këtij hulumtimi është aprovuar nga Këshilli i ShKÇAK dhe është publikuar.

Pas publikimit të raportit, ShKÇAK ka organizuar një takim me të gjithë auditorët ligjor ku janë diskutuar gjetjet kryesore të hulumtimit dhe janë këshilluar mbi anashkalimin e tyre në të ardhmen. Duke u cilësuar nga KKRF si një hulumtim mjaft cilësor, ShKÇAK do të vazhdoj ta bëj këtë hulumtim në baza dy-vjeçare në mënyrë që të përcillet cilësia e raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë.

Viti 2017 do të jetë një vit i zhvillimeve më intensive në aspektin e kontrollit të cilësisë. ShKÇAK për herë të parë do të fillojë implementimin e rregullores së kontrollit të cilësisë për auditorët ligjor të aprovuar nga Këshilli i ShKÇAK, me ç'rast do të realizohet një kontroll i mirëfilltë i cilësisë së punës së auditorëve ligjor.

Në fund me lejoni të përgëzoj Zyrën ekzekutive të ShKÇAK, e veçanërisht Departamentin e Kontrollit të Cilësisë për punën dhe sukseset e arritura gjatë vitit 2016 në fushën e kontrollit të cilësisë duke kontribuar kështu në realizimin e misionit të ShKÇAK për mbrojtje të interesit publik.

**Lekë Musa**

**Kryesues i Komisionit të Kontrollit të Cilësisë**



Nga e majta: Fahri Breznica, Ardiana Bunjaku, Naim Avdiu,  
mungojnë Lekë Musa, Paul Hurks





## Raport nga Komisioni për Standarde Profesionale

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni për standarde profesionale monitoron zhvillimet në fushën e raportimit financiar dhe auditimit. Komisioni shërben si pikë referimi dhe diskutimi të temave profesionale për anëtarësin.

Përkundër përmirësimeve të vazhdueshme, përmirësimi i ambientit rregullativ në fushën e raportimit financiar dhe auditimit mbetet objektiv i komisionit.

Komisioni ka diskutuar tema të ndryshme në interes të zhvillimit të mëtutjeshëm të raportimit financiar dhe Auditimit në Kosovë.

Komisioni ka kontribuar aktivisht në procesin e projektit të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për kontabilitet dhe raportim financiar duke dërguar kontributin e anëtarëve në formë të komenteve në komisionin përkatës parlamentar. Në hartimin e komenteve kemi marrë parasysh se pari interesin publik që bartë profesioni ynë ndaj shoqërisë dhe avancimin e mëtutjeshëm të pozitës dhe rolit të profesionistëve kontabilistë dhe auditorë në ekonominë e Kosovës.

Komisioni rikonfirmon përkushtimin e anëtarësisë për kompetencë dhe sjellje profesionale si cilësitë e domosdoshme të kontabilistëve dhe auditorëve.

Komisioni inkurajon anëtarët tanë të veprojnë me kujdes dhe në pajtim me standardet e aplikueshme profesionale dhe teknike gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre.

Avancimi i vazhdueshëm i kompetencës profesionale dhe avancimi i anëtarëve tanë në një fushë shumë dinamike të standardeve profesionale mbetet objektiv kryesor i punës së komisionit. Kjo pasi bizneset tona garojnë në një konkurrencë globale ku kërkesat për shërbime profesionale të cilësisë më të lartë paraqiten si domosdoshmëri për sukses.


Prandaj Komisioni vazhdon të jetë i përkushtuar në zhvillimin e standardeve më të larta profesionale të raportimit financiar dhe auditimit.

**Adrian Alo**  
Kryesues i Komisionit për standarde profesionale




*Nga e majta: Nazmi Pllana, Adrian Alo, Bekim Berisha, Arbër Hoti, Alban Lufi mungojnë Jan tyl, Teuta Ukshini, Lulzim Berisha, Xhevdet Beqiri*

## STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHKÇAK



## STATISTIKAT E VITIT 2016

SHKÇAK shënon trend të avancimit të pozitës së femrës në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit




ShKÇAK, i kushton një hapësirë të konsiderueshme përfshirjes së femrave brenda strukturës së vet të anëtarësisë dhe angazhohet për avancimin e pozitës së tyre si profesioniste të kontabilitetit dhe auditimit.

Bazuar në grafikonin e mësipërm, përqindja e pjesëmarrjes së femrave në profesion nga viti 2002 deri në vitin 2016 ka shënuar rritje të vazhdueshme. Kështu, në vitin 2002 përqindja e femrave, të cilat kanë fituar thirrje në të gjitha nivelet e çertifikimit të Shoqatës, ishte 14% në krahasim me numrin e përgjithshëm të të çertifikuarve, duke vazhduar me një rritje prej 30%, në vitin 2008 dhe duke avansuar me 46% të femrave të çertifikuara në programet çertifikuese të ShKÇAK, gjatë vitit 2010.

Ky trend pozitiv i pjesëmarrjes së femrave në profesion, gjatë vitit 2016 ka shënuar një rritje rekorde me 53% të femrave të çertifikuara, krahasuar me numrin e përgjithshëm të të çertifikuarve në të gjitha nivelet e çertifikimit të Shoqatës, që dëshmon për një interesim të shtuar të femrave për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit dhe për të qenë pjesë e Shoqatës, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e pozitës së tyre si profesioniste në vend dhe ka fuqizuar zërin përfaqësues të femrës në këto fusha profesionale.

ShKÇAK, edhe më tej vazhdon të shënojë trend të rritjes së numrit të studentëve të rinj të regjistruar në programet çertifikuese të saj




Besueshmëria në ShKÇAK, programet cilësore çertifikuese të bazuara në plan-programet më të avancuara ndërkombëtare dhe përfitimet që rezultojnë nga kualifikimet e fituara të pranuar ndërkombëtarisht nga një numër i organizatave profesionale, ka rezultuar në rritjen e interesimit të studentëve të rinj për të ndjekur programet çertifikuese të ofruara nga Shoqata, pavarësisht nga konkurrenca e paraqitur viteve të fundit.

Grafikoni i mësipërm tregon se numri i studentëve të rinj të regjistruar në ShKÇAK gjatë vitit 2014 ka qenë 325, për të vazhduar me 381 studentë të regjistruar gjatë vitit 2015, apo 8% më shumë se sa gjatë vitit paraprak.

Ndërsa, trendi i regjistrimit ka shënuar rritje të dukshme në vitin 2016, me 445 studentë të rinj të regjistruar apo 17% më shumë gjatë këtij viti, krahasuar me vitin 2015.


## Sektorët në të cilët kontribuojnë anëtarët e SHKÇAK



Zhvillimi i mirëfilltë i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit ka ndikim mjaft të madh, që reflektohet drejtpërdrejt në përmirësimin e sektorëve ekonomik dhe financiar në Kosovë, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Për të realizuar këto zhvillime pozitive është e nevojshme që shtrirja dhe kontributi i profesionistëve të mbulojë sektorë të ndryshëm.

Nga grafikoni shihet se, edhe gjatë vitit 2016 Shoqata përmes anëtarëve të saj, ka arritur të mbulojë të gjithë sektorët relevantë, duke filluar me 38% të anëtarëve të saj të përfshirë në biznes dhe industri, 21% studentë, 12% firma të kontabilitetit dhe auditimit, 11% të anëtarëve janë të përfshirë në sektorin publik, 1% në Akademi dhe Edukim dhe 17% në fusha të tjera, që dëshmon edhe njëherë angazhimin e Shoqatës për ngritje të kapaciteteve përmes certifikimeve të specializuara në fusha të ndryshme.

## Trendi i rritjes së numrit të çertifikuarve gjatë tri viteve të fundit



Statistikat e SHKÇAK flasin për një rritje të theksuar të numrit të anëtarëve të çertifikuar nga viti 2014-2016, në të tri nivelet e çertifikimeve, ku vërehet një interesim i shtuar për pjesëmarrje në nivelin Teknik të Kontabilitetit.

Bazuar në grafikonin e paraqitur, gjatë vitit 2014 janë çertifikuar 118 studentë, prej të cilëve 87 apo 74% në nivelin Teknik të Kontabilitetit, 17 apo 15% në nivelin Kontabilist të Çertifikuar, 14 apo 12% Auditorë të Çertifikuar.

Në vitin 2015 janë çertifikuar gjithsej 108 studentë, prej të cilëve 80 apo 74% janë çertifikuar në nivelin Teknik të Kontabilitetit, 13 apo 12% në nivelin Kontabilist i Çertifikuar, 15 apo 14% Auditorë të Çertifikuar.

Në vitin 2016, janë çertifikuar gjithsej 122 studentë, prej të cilëve 89 apo 81% janë çertifikuar në nivelin Teknik të Kontabilitetit, 14 apo 11% në nivelin Kontabilist i Çertifikuar dhe 9 apo 7% Auditorë të Çertifikuar.



**Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës**

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur  
31 dhjetor 2016**

## PËRMBAJTJA

Raporti i auditorëve të pavarur	3
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	6
Pasqyra e pozitës financiare	7
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë	9
Shënimet e pasqyrave financiare	10-24



## Raport i Auditorit të Pavarur

Drejtuar: Këshillit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

### Raport mbi Pasqyrat Financiare

#### Opnioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (tutje referohet si “Organizata” apo “ShKÇAK”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 6-24.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2016, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

#### Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Ne kemi vendosur se nuk ka çështje të rëndësishme të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

#### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

#### Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.


Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

Audit & Conto,

  
Ymer Shatri  
Partner Angazhimi  
29 Mars 2017




## Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

	Shënimet	(në Euro)	
		Viti i përfunduar me 31 Dhjetor	
		2016	2015
<b>Të hyrat operative</b>			
Të hyrat nga edukimi	3	317,235	292,784
Të hyrat nga anëtarësimi	3	122,115	103,167
Të hyrat tjera	3	7,450	
Të hyrat nga BQK	3	5,788	
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	3	4,800	3,100
Të hyrat nga forumi	3	10,300	
		<b>467,688</b>	<b>399,051</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet administrative	4	151,264	131,866
Shpenzimet e trajnimit	5	163,441	134,263
Shpenzimet e provimeve	6	23,510	21,158
Shërbimet për anëtarë	7	136,291	116,166
		<b>474,506</b>	<b>403,453</b>
<b>Teprica (deficiti) e akumuluar e të hyrave</b>		<b>(6,818)</b>	<b>(4,402)</b>


**Ermal Kozgori**

Udhëheqës i financave



**Ardiana Bunjaku**

Drejtoreshë Ekzekutive



Shënimet shpjeguese nga faqe 10 në faqe 24 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

6


**Pasqyra e pozitës financiare**(në Euro)  
Me 31 Dhjetor  
2015

	Shënimet	2016	2015
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	8	490,163	501,269
Parapagimet	9	4,837	-
Të arkëtueshmet	10	5,662	2,963
Të arkëtueshmet e grantit BQK		50	5,838
Stoqet - librat		3,675	-
		<b>504,387</b>	<b>510,070</b>
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe paisjet	11	6,034	8,375
Pasuritë e paprekshme	12	37,091	460
		<b>43,125</b>	<b>8,835</b>
<b>Totali i pasurive</b>		<b>547,512</b>	<b>518,905</b>
<b>Detyrimet afat-shkurta</b>			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	13	17,641	13,940
Të hyrat e shtyra	14	115,231	83,506
		<b>132,872</b>	<b>97,446</b>
<b>Fondet</b>			
Teprica e akumuluar e të hyrave		414,640	421,458
		<b>414,640</b>	<b>421,458</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe fondëve</b>		<b>547,512</b>	<b>518,905</b>


Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i ShKÇAK më 28 Shkurt 2017 dhe janë nënshkruar nga,

**Ermal Kozgori**

Udhëheqës i financave


**Ardiana Bunjaku**

Drejtoreshë Ekzekutive



Shënimet shpjeguese nga faqe 10 në faqe 24 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

7

## Pasqyra e Ndryshimeve në Fonde

	Me 31 Dhjetor 2016	(në Euro) Me 31 Dhjetor 2015
<b>Me 01 Janar</b>	421,458	425,861
Teprica (suficiti) e të hyrave për vitin	(6,818)	(4,402)
<b>Teprica e akumuluar e të hyrave Me 31 Dhjetor</b>	<b>414,640</b>	<b>421,458</b>

## Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

	Shënimet	2016	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor	2015
<b>AKTIVITETET OPERATIVE</b>				
Fitimi / (humbja) e vitit		<b>(6,818)</b>		<b>(4,402)</b>
Zhvlërimi dhe amortizimi		4,599		8,291
Të arkëtueshmet		(2,699)		1,171
Parapagimet		(4,838)		
Stoqet – librat		(3,675)		
Detyrimet tregëtare dhe te tjera		3,702		3,185
Të hyra të shtyra		37,511		(961)
<b>Paraja neto nga aktivitetet operative</b>		<b>27,783</b>		<b>7,284</b>
<b>AKTIVITETET INVESTUESE</b>				
Blerja e pajisjeve		(2,028)		(7,480)
Pasurite e paprekshme		(36,861)		
<b>Paraja neto nga aktivitetet investuese</b>		<b>(38,889)</b>		<b>(7,480)</b>
<b>AKTIVITETET FINANCUESE</b>				
Rrjedha neto e parasë për periudhën		(11,106)		(196)
Gjendja e parasë në fillim		501,269		501,464
<b>Gjendja e parasë në fund</b>		<b>490,163</b>		<b>501,269</b>

Shënimet shpjeguese nga faqe 10 në faqe 24 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

9

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

### 1. Të përgjithshme

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (“SHKÇAK” ose “Organizata”) është organizatë jo profitabile e themeluar në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligji Nr.03/L-134 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. SHKÇAK është themeluar për qëllim të:

Profesionalizmit të Ndërsjellë: për të përkrahur, mbrojtur dhe avancuar karakterin, statusin dhe interesat e profesionit të kontabilitetit në përgjithësi dhe të kontabilistëve e auditorëve në veçanti që janë anëtarë të SHKÇAK;

Rritjes Profesionale: që të lehtësojë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të anëtarëve përgjatë karrierës së tyre;

Integritetit: për të mbajtur nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe integritetit të anëtarëve në interes të komunitetit; dhe

Përfaqësimit: për të përfaqësuar profesionin në komunitet.

Me 31 dhjetor 2016 dhe 2015, Organizata ka kryer aktivitetet me 16 dhe 15 të punësuar përkatësisht.

### 2. Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyra pasqyrave financiare:

#### 2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë shprehur në Euro.

#### 2.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

#### 2.3 Zbatimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara

Në vitin aktual, Organizata ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme dhe efektive për periudhën që fillon me ose pas datës 1 janar 2016.

#### Ndryshimet në SNK 1 Iniciativa e shpalosjeve

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet qartësojnë se entiteti nuk ka nevojë të ofrojë shpalosje specifike të kërkuar nga SNRF nëse informata rezultuese nga shpalosja nuk është materiale dhe ofron udhëzime për bazën e agregimit dhe disagregimit të informatave për qëllime të shpalosjes. Mirëpo, ndryshimet ritheksojnë se entiteti duhet të konsideroj ofrimin e shpalosjeve shtesë kur pajtueshmëria me kërkesën specifike në SNRF është e pamjaftueshme për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ndikimin e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve specifike mbi pozitën financiare dhe performancën financiare të entitetit.



Sa i përket strukturës së pasqyrave financiare, ndryshimet ofrojnë shembuj të rradhitjes ose grupimit sistematik të shënimeve.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka rezultuar më ndonjë ndikim në performancën financiare ose pozitën financiare të Organizatës.

#### **Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 Qartësimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit**

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet në SNK 16 ndalojnë entitetet të përdorin zhvlerësimin e bazuar në të hyra si metodë të zhvlerësimit për zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve. Ndryshimet në SNK 38 paraqesin supozime të kundërshtueshme se të hyrat nuk janë bazë e duhur për amortizimin e një pasurie të patrupëzuar. Ky supozim mund të kundërshtohet në dy rrethanat e kufizuara në vijim.

- a) Kur pasuria e patrupëzuara është shprehur si masë e të hyrave; ose
- b) Kur mund të demonstron se të hyrat dhe konsumimi i përfitimit ekonomik i pasurisë së patrupëzuar janë në një korelacion të lartë.

Pasi që Organizata tashmë përdor metodën drejtëvizore të zhvlerësimit dhe amortizimit për pasuritë joqarkullese dhe pasuritë e patrupëzuara përkatësisht, zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Organizatës.

#### **Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 Bujqësia: Bimët bartëse**

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet përkufizojnë bimët bartëse dhe kërkojnë që pasuritë biologjike që përmbushin përkufizimin e një bime bartëse të trajtohet si pronë, impiant dhe pajisje në pajtueshmëri me SNK 16, në vend të SNK 41. Frytet që rriten në bimët bartëse vazhdojnë të trajtohen në pajtueshmëri me SNK 41.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të organizatës pasi që organizata nuk është përfshirë në aktivitete bujqësore.

#### **Përmirësimet vjetore në Ciklin 2012-2014 të SNRF**

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Përmirësimet vjetore në ciklin 2012-2014 të SNRF përfshijnë një numër të ndryshimeve në SNRF të ndryshme, të cilat janë përmbledhur më poshtë.

Ndryshimet në SNRF 5 paraqesin udhëzime specifike në SNRF 5 për entitetet që riklasifikojnë një pasuri (ose grup të shlyerjes) nga ajo që mbahet për shitje në pasuri të mbajtur për shpërndarje të pronarët (ose e kundërta). Ndryshimet qartësojnë se një ndryshim i tillë duhet të konsiderohet si vazhdimësi e planit origjinal të shlyerjes/shitjes prandaj kërkesat e paraqitura në SNRF 5 lidhur me ndryshimin e planit të shitjes nuk zbatohen. Ndryshimet po ashtu qartësojnë udhëzimet se kur ndërpritet kontabiliteti i mbajtjes për shpërndarje.

Ndryshimet në SNRF 7 ofrojnë udhëzime shtesë për të qartësuar nëse një kontratë e shërbimeve është përfshirje e vazhdueshme në një pasuri të transferuar për qëllim të shpalosjeve të kërkuara lidhur me pasuritë e transferuara.

Ndryshimet në SNK 19 qartësojnë se norma e përdorur e skontimit të obligimeve pas-punësimit duhet të përcaktohet duke iu referuar rendimentit të tregut në fund të periudhës së raportimit në bono korporative të cilësisë së lartë. Vlerësimi i thellësisë së tregut për bono të cilësisë së lartë duhet të jetë në nivelin e valutës (dmth në valutën e njëjtë në të cilën do të paguhen përfitimet). Për valutat për të cilat nuk ka treg të thellë në bono të tilla korporative me cilësi të lartë, duhet të përdoret rendimenti i tregut në fund të periudhës raportuese për bonot qeveritare të denominuara në atë valutë.

Zbatimi i këyre ndryshimeve nuk ka pasur efekt në pasqyrat financiare të organizatës.

### 2.3.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese të cilat nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese janë publikuar nga BSNK të cilat nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar nga Organizata. Informatat për ndryshimet që pritet të jenë relevante për Kompaninë, janë paraqitur më poshtë.

Menaxhmenti pret se të gjitha publikimet do të adoptohen në politikat kontabël të organizatës për periudhën e parë që fillon pas datës efektive të publikimeve. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë adoptuar ose nuk janë listuar më poshtë nuk pritet të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

#### SNRF 9 Instrumentet financiare

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF9) paraqet ndryshime domethënëse në udhëzimet e SNK 39 për riklasifikimin dhe matjen e pasurive financiare dhe paraqet modelin e ri të 'humbjes së pritur kreditore' për dëmtimin e pasurive financiare. SNRF 9 po ashtu ofron ushëzime të reja mbi zbatimin e kontabilitetit mbrojtës. Menaxhmenti ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9 por nuk është ende në pozitë të ofrojnë informata të kuantifikuara.

SNRF 9 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

#### SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të hyrave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të hyrat', SNK 11 'Kontratat ndërtimore' dhe disa interpretime që lidhen me të hyrat. Parimi themelor i SNRF 15 është që entiteti duhet të njoh të hyrat ashtu që ilustron transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara te konsumatorët në shumën që reflekton konsideratën për të cilën entiteti ka të drejtën si shkëmbim për ato mallra ose shërbime.

SNRF 15 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

#### SNRF 16 Lizingu

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënësit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jasht bilancit) dhe lizingut financiar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përveç për lizingjet afatshkurta dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

SNRF është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofroj informata të kuantifikuara.

#### 2.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

#### 2.5 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

#### 2.6 Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

#### 2.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

Organizata njeh të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim:

Tarifat e anëtarisë dhe tarifat e edukimit janë njohur fillimisht kur është lëshuar fatura. Të hyrat janë rregulluar në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e fituara gjatë vitit.

Të hyrat nga tarifat e edukimit dhe anëtarimit janë shtyrë për pagesat e pranuar për paradhënie.

#### 2.8 Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlersimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlersimi është ngarkuar duke përdorur metodën e bilancit zbritës në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

#### 2.9 Prona, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

	2016	2015
Mobiljet dhe paisjet	2-5 vite	2-5 vite
Paisjet e TI nën 1,000 Euro	3 vite	3 vite
Veturat	5 vite	5 vite

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

#### 2.10 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njejta përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e paprekshme të Organizatës përmbajnë Softuerë kompjuterik, të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave dhe licence nga Agjensioni Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) Gjithashtu këto pasuri përfshijnë koston e përkthimit të librave të programit të auditimit të brendshëm e cila është kapitalizuar si kosto e zhvillimit në pajtueshmëri me SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

#### 2.11 Dëmtimi i pasurive të prekshme dhe të paprekshme

Në fund të secilës periudhë raportuese, Organizata rishikon shumat bartëse të pasurive të prekshme dhe të paprekshme të saj për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dëshmi që ato pasuri kanë humbje nga dëmtimi. Nëse ekziston ndonjë informacion i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet masa e humbjeve nga dëmtimi (nëse ka).

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e huadhjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës së përdorimit, rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme janë të skontuara në vlerën e tyre të tanishme duke përdorur normën e skontimit të para-tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe riskun specifik të pasurisë për të cilën vlerësimet e rrjedhëve të ardhshme të parasë nuk kanë qenë të rregullurara.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie vlerësohet të jetë më e vogël se vlera bartëse e saj, vlera bartëse e pasurisë zvogëlohet në shumën e rikuperueshme të saj. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim apo humbje, përveç rastit kur pasuria përkatëse mbahet me shumën e rivlerësuar, ku në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si rënje e rivlerësimit.

Pasuritë që janë subjekt i amortizimit janë rishikuar për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Vlera bartëse e një pasurie është shënuar menjëherë në vlerë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e një pasurie është më e lartë se vlera e rikuperueshme që është vlerësuar të jetë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e vlerës reale të pasurisë minus kosto e shitjes dhe vlerës në përdorim.

## 2.12 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njeh si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe  
Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

## 2.13 Instrumentet Financiare

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Organizata bëhet pjesë e marrëveshjeve kontraktuale të instrumenteve.

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë. Kostot e transaksioneve të cilat i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare u shtohen apo i zbriten vlerës së drejtë të pasurive financiare apo detyrimeve financiare, në mënyrë të përshtatshme në njohjen fillestare. Kostot e transaksioneve të atribuueshme direkt blerjes së pasurive financiare apo detyrimeve financiare në vlerën e tyre të drejtë përmes fitimit apo humbjes njihen menjëherë në fitim apo humbje.

### Pasuritë financiare

Pasuritë financiare klasifikohen në kategoritë specifike siç janë: pasuritë financiare 'në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes' (VDPFH), investimet 'e mbajtura deri në maturim', pasuritë financiare 'të gatshme-për-shitje' (GPSH) dhe 'huatë dhe të arkëtueshmet'. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i pasurive financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet apo shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në bazë të datës së tregtimit. Blerjet apo shitjet në mënyrën e rregullt janë blerjet apo shitjet e pasurive financiare të cilat kërkojnë shpërndarjen e pasurive brenda kohës së caktuar nga rregullimi apo marrëveshja në treg.

### *Metoda efektive e interesit*

Metoda efektive e interesit është metoda e kalkulimit të kostos së amortizuar të një instrumenti të borxhit dhe të alokimit të të hyrave nga interesi përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit e cila saktësisht skanton arkëtimet e ardhshme të parasë, të vlerësuar përmes jetës së pritur të instrumentit të borxhit, apo, ku është e përshtatshme, një periudhe më të shkurtër, vlerës neto bartëse në njohjen fillestare.

Të hyrat njihen në baza të interesit efektiv për instrumentet e borxhit, të ndryshme nga ato të cilat klasifikohen si VDPFH.

#### *Pasuritë financiare të VDPFH*

Pasuritë financiare klasifikohen si VDPFH kur pasuria financiare është (i) konsideratë kontigjente e cila mund të paguhet nga një blerje si pjesë e kombinimit të biznesit për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, ose (iii) janë të përcaktuara si VDPFH.

#### *Investimet e mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe data fikse të maturimit, ku Organizata ka qëllim pozitiv dhe mundësi të i mbaj deri në maturim. Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim vlerësohen sipas kostos së amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit minus çfarëdo dëmtimi.

#### *Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme*

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregun aktiv. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme (duke përfshirë të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, parane e gatshme dhe parane në bankë) vlerësohen sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, minus çfarëdo dëmtimi.

#### *Pasuritë financiare të gatshme-për-shitje (pasuritë financiare GPSH)*

Pasuritë financiare GPSH janë jo-derivate të cilat janë të përcaktuara sikur GPSH apo nuk klasifikohen si (a) huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, (b) investimet që mbahen deri në maturim apo (c) pasuritë financiare në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

#### *Dëmtimi i pasurive financiare*

Pasuritë financiare, të ndryshme nga VDPFH, vlerësohen si indikatorë të dëmtimit në fund të secilës periudhë raportuese. Pasuritë financiare konsiderohen të dëmtuara kur ka dëshmi që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që ndodhin pas njohjes fillestare të pasurive financiare, janë ndikuar rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme të vlerësuara të investimeve.

Për instrumentet e ekuitetit GPSH, një rënje domethënëse apo e zgjatuar në vlerën e drejtë të letrës me vlerë posttë kostos së tij konsiderohet të jetë dëshmi e dëmtimit.

Për të gjitha pasuritë e tjera financiare, dëshmi të vlefshme të dëmtimit mund të përfshijnë:

*Vështirësitë financiare domethënëse të emetuesit apo të palës tjetër;*

*Prishja e kontratës, siç është mospagesa apo shkelja në pagesat e interesit apo kryegjësë;*

*Mundësia që huamarrësi të ketë falimentim apo ri-organizim financiar; apo*

*Humbja e një tregu aktiv për pasuritë financiare për shkak të vështirësive financiare.*

Për disa kategori të pasurive financiare, siç janë llogaritë e arkëtueshme tregtare, pasuritë vlerësohen për dëmtim në baza kolektive edhe nëse individualisht nuk janë vlerësuar për dëmtim. Dëshmitë e vlefshme të dëmtimit për një portfolio të llogarive të arkëtueshme mund të përfshijnë përvojën e kaluar të mbledhjes së pagesave të Organizatës, një rritje në numrin e pagesa të vonuara në portfolio, si dhe ndryshimet e dukshme në kushtet ekonomike kombëtare apo lokale të cilat lidhen me mospagesën e llogarive të arkëtueshme.

Për pasuritë financiare të cilat vlerësohen sipas kostos së amortizimit, shuma e njohur e humbjeve nga dëmtimi është diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë në vlerën e tanishme dhe vlerës së tanishme të rrjedhës së parasë, e skontuar në normën efektive origjinale të pasurisë financiare.

Për pasuritë financiare që vlerësohen sipas kostos së amortizuar, nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga dëmtimi bie, dhe rënja mund të jetë e lidhur objektivisht me një ngjarje që ndodhë pas njohjes së dëmtimit, humbja nga dëmtimi i njohur në fillim kthehet mbrapsht përmes fitimit apo humbjes deri në masën që shuma e bartur e investimin në datën e dëmtimit të kthyer mbrapsht nuk e tejkalon shumën e kostos së amortizuar që do të kishte qenë nëse dëmtimi nuk do të ishte njohur.

#### *Çnjohja e pasurive financiare*

Organizata e çnjeh pasurinë financiare kur të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parasë për largimin e pasurive, apo transferimin e pasurisë financiare dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasurisë i kalojnë palës tjetër.

Në çnjohje të plotë të pasurisë financiar, diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë dhe shumës së konsideratës së pranuar dhe llogarive të arkëtueshme dhe humbjet apo fitimet kumulative që ishin njohur në pasqyrën tjetër gjithëpërfshirëse dhe të akumuluar në ekuitet njihet në fitim apo humbje.

#### **Detyrimet financiare**

Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime financiare 'VDPFH' apo 'detyrime financiare të tjera'

#### *Detyrimet financiare VDPFH*

Detyrimet financiare klasifikohen si VDPFH kur detyrimi financiar është (i) konsiderata kontigjente e cila mund të paguhet në blerje si pjesë e kombinimit biznesor për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, apo (iii) është e përcaktuar si VDPFH.

#### *Detyrimet financiare të tjera*

Detyrimet financiare të tjera (përfshirë huazimet dhe të pagueshmet tregtare dhe të tjera) janë më pas të vlerësuara me koston së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit.

#### *Çnjohja e detyrimeve financiare*

Organizata i çnjeh detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur obligimet e Organizatës shkarohen, anulohen apo shuhen. Diferenca në mes të shumës bartëse të detyrimit financiar të çnjohur dhe konsiderata e paguar dhe të pagueshmet njihen tek fitimi dhe humbja.

#### **2.14 Shpenzimet**

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

### 2.15 Benefitet e të punësuarve

Organizata kontribon në planë pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Organizata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

### 2.16 Tatimi në fitim

SHKÇAK është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. SHKÇAK gjatë vitit 2016 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave. Organizata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimor me 31 Dhjetor 2016 dhe 2015, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

### 2.17 Menaxhimi i riskut financiar

#### Risku kreditor

Risku kreditor paraqet riskun që pala tjetër të dështoj në kryerjen e obligimeve kontraktuale që rezultojnë në humbje financiare të Organizatës. Organizata ka adoptuar një politikë për të kontraktuar vetëm palët e besueshme dhe të siguroj dëshmi të mjaftueshme, për të zvogëluar rrezikun e humbjes financiare nga dështimi në kryerjen e pagesave. Organizata siguron që njeh vetëm të arkëtueshmet nga individët e organizatave të mirëformuara në Kosovë. Ekspozimi ndaj kredive kontrollohet në baza periodike nga Zyrtari Ekzekutiv dhe Këshilli.

#### Risku i tregut

Risku i tregut është risku i cili ndryshon me ndryshimin e çmimeve të tregut, siç janë ndryshimi i kursit valuator i jashtëm dhe i normave të interesit që do të ndikojnë në të hyrat e Organizatës apo vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare të saj. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është menaxhimi dhe kontrollimi i ekspozimit të riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, gjatë optimizimit të kthimit. Përderisa nuk ka transaksione materiale në valutën e huaj dhe përderisa nuk ka interes në fondet e huazuara nga institucionet financiare lokale dhe të jashtme në datën e pozicionit financiar, Organizata nuk ekspozohet ndaj çfarëdo ndryshimi të kursit të këmbimit dhe rrezikut të normave të interesit.

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Pasuritë</b>		
Paraja e gatshme dhe në bankë	490,163	501,269
<b>Totali</b>	<b>490,163</b>	<b>501,269</b>



### Risku i likuiditetit

Përgjegjësia themelore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit i takon Këshillit të ShKÇAK. Menaxhimi i matur i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, disponueshmëri të fondeve përmes lehtësirave për kredi dhe mundësisë për t'i mbledhur në kohën e duhur, brenda kushteve të shumave të vendosura për shkak të konsumatorëve. Organizata menaxhon riskun e likuiditetit duke mbajtur rezerva të mjaftueshme, lehtësira bankare dhe duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme planifikimin dhe rrjedhën aktuale të parasë, dhe duke koordinuar profilet e maturitetit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Tabelat në vijim paraqesin maturitetet kontraktuale të mbetura të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të Organizatës. Tabelat përgatiten në baza të rrjedhave të parasë të paskontuara të detyrimeve financiare.

	31 Dhjetor 2016			
	Qarkulluese Deri në 1 vit (Euro)	Jo - qarkulluese 1 deri 2 vite (Euro)	2 deri 5 vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
<b>Pasuritë financiare</b>				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	490,163	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	5,662			
<b>Totali i pasurisë</b>	<b>495,825</b>	-	-	-
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	17,641			
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>17,641</b>	-	-	-

	31 Dhjetor 2015			
	Qarkulluese Deri në 1 vit (Euro)	Jo - qarkulluese 1 deri 2 vite (Euro)	2 deri 5 vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
<b>Pasuritë financiare</b>				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	501,269	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	2,963			
<b>Totali i pasurive financiare</b>	<b>504,232</b>	-	-	-
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	13,940	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>13,940</b>	-	-	-

### Instrumentet financiare që nuk paraqiten në vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare që nuk paraqiten në Pasqyrën e pozitës financiare në vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera bartëse 2016	Vlera e drejtë 2016	Vlera bartëse 2015	Vlera e drejtë 2015
<b>Pasuritë financiare</b>				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	490,163	490,163	501,269	501,269
Llogaritë e arkëtueshme	5,662	5,662	2,963	2,963
<b>Totali i pasurive financiare</b>	<b>495,825</b>	<b>495,825</b>	<b>504,232</b>	<b>504,232</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	17,641	17,641	13,940	13,940
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>17,641</b>	<b>17,641</b>	<b>13,940</b>	<b>13,940</b>

### 2.18 Ngjarjet pasuese

Ngjarjet pas përfundimit të vitit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Organizatës në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarje pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në pasqyra financiare kur kanë qenë materiale.

### 3 Të hyrat

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015
		(në Euro)
Regjistrimi	9,260	8,950
Trajnimi	203,280	169,520
Provimet	79,530	75,556
Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	21,915	25,983
Trajnimi - ZAP		5,275
Provimet - ZAP	3,250	7,500
<b>Gjithsej të hyra nga edikimi</b>	<b>317,235</b>	<b>292,784</b>
Të hyrat nga anëtarësimi	122,115	103,167
<b>Gjithsej të hyrat nga anëtarësimi</b>	<b>122,115</b>	<b>103,167</b>
Të hyrat tjera	7,450	
Te hyra nga granti BQK	5,788	
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	4,800	3,100
Te hyrat nga forumi	10,300	
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>467,688</b>	<b>399,051</b>

#### 4 Shpenzimet administrative

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015
Pagat	105,943	91,207
Zhvlersimi (Shënimi 10)	4,369	8,061
Amortizimi (Shënimi 11)	230	230
Qiraja	10,800	10,800
Shërbimet komunale	3,193	4,379
Shpenzime të komunikimit	2,668	2,354
Furnizime të zyrës	2,769	3,476
Auditimi	2,583	1,195
Renovimi i zyrës	1,217	662
Sigurimi shëndetësor	2,322	2,910
Mirëmbajtja e veturës	3,337	2,446
Zhvillimi i personelit	1,099	
Shpen.e borxheve të këqija	1,052	180
Reprezentacion	5,942	3,966
Shpenzimet tjera	3,740	
<b>Gjithsej shpenzimet administrative</b>	<b>151,264</b>	<b>131,866</b>

#### 5 Shpenzimet e trajnimit

Shpenzimet e trajnimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 ishin si në vazhdim:

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015
Mbajtja e trajnimeve	94,475	82,891
Qiraja	22,800	22,700
Shtypja e materialeve	9,235	10,010
Shpenzimet e trajnimit – ZAP	19,346	1,575
Shpenzimet e rrymes – trajnime	2,191	1,397
Te drejtat autoriale nga BPP, perkthimi dhe azhurnimi	11,705	14,185
Shpenzimet e auditimi te brendshem	1,576	
Tjera	2,113	1,505
<b>Gjithsej shpenzimet e trajnimeve</b>	<b>163,441</b>	<b>134,263</b>

## 6 Shpenzimet e provimeve

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015
Përpilimi, korigjimi	9,900	9,484
Mbikqyrja	6,297	6,049
Qiraja	2,160	2,160
Shtypja	2,592	2,288
Shpenzimet e provimeve - ZAP	1,995	660
Tjera	566	517
<b>Gjithsej shpenzimet e provimeve</b>	<b>23,510</b>	<b>21,158</b>

## 7 Shërbimi për anëtarë

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2015
Edukimi i vazhdueshëm profesional	26,734	21,557
Këshilli dhe komisionet	7,791	3,728
Udhëtimet	15,627	11,917
Takimet vjetore dhe ceremonitë	11,640	8,754
Anëtarësia në organizata	14,190	10,821
Seminare dhe punëtori	5,725	3,850
Pagat – shërbimi për anëtarë	28,407	17,821
Zhvillimi i certifikimeve tjera dhe kc	21,473	30,453
Marketingu	1,715	2,471
Ueb-faqja dhe TI	2,989	4,794
<b>Gjithsej shpenzimet për anëtarë</b>	<b>136,291</b>	<b>116,166</b>

## 8 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Llogari rrjedhëse - Pro Credit Bank	30,742	266,211
Llogari rrjedhëse - Banka Private Biznesit	100,517	126,126
Llogari rrjedhëse - Banka Private Biznesit USD	77	87
Llogari rrjedhëse - Banka Ekonomike	108,827	108,845
Depozitat afatshkurta te depozituara	250,000	
	<b>490,163</b>	<b>501,269</b>

## 9 Parapagimet

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Parapagimet	4,837	
	<b>4,837</b>	

## 10 Të arkëtueshmet

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor	
	2016	2015
Të arkëtueshmet nga anëtarët	6,291	3,292
Të tjera	-	-
Minus: Provisioni për të arkëtueshmet e këqia dhe të dyshimta nga anëtarët	(629)	(329)
	<b>5,662</b>	<b>2,963</b>

## 11 Prona, impiantet dhe paisjet

	Kompjuteret dhe pajisjet tjera	Automjeti	Totali
<b>Me 1 Janar 2016</b>			
Kosto	60,943	12,667	73,610
Zhvleresimi i akumuluar	(52,990)	(12,244)	(65,234)
<b>Vlera neto në libra</b>	<b>7,953</b>	<b>422</b>	<b>8,375</b>
<b>Lëvizjet gjatë vitit 2016</b>			
Vlera neto në libra	7,953	422	8,375
Shtesat	2,028	-	2,028
Shlyerjet	-	-	-
Zhvlerësimi	(3,947)	(422)	(4,369)
<b>Vlera e bartjes</b>	<b>6,034</b>	<b>-</b>	<b>6,034</b>
<b>Me 31 Dhjetor 2016</b>			
Kosto	62,971	12,667	75,637
Zhvleresimi i akumuluar	(56,937)	(12,667)	(69,603)
<b>Vlera neto në libra</b>	<b>6,034</b>	<b>-</b>	<b>6,034</b>

## 12 Pasuritë e patrupëzuara

	Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2015
<b>Me 31 Dhjetor</b>		
Kosto	41,037	41,037
Shtesat gjatë vitit	36,861	-
Amortizimi i vitit	(230)	(230)
Amortizimi i akumuluar	(40,807)	(40,577)
<b>Vlera neto në libra</b>	<b>37,091</b>	<b>460</b>

### 13 Detyrimet tregtare dhe të tjera

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2015
Detyrimet për kontributin e tatimit të të ardhurave personale mbi pagat	9,758	5,700
Detyrimet për shërbimet e auditimit	2,583	1,195
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	5,084	5,394
Të pagueshme ndaj punonjësve	216	1,651
	<b>17,641</b>	<b>13,940</b>

### 14 Të hyrat e shtyra

Analiza e balancës

Me 31 Dhjetor 2016 dhe 2015, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2015
Tarifat e shtyra të edukimit	115,181	77,668
Grantet e shtyra:		
- Granti BQK	50	5,838
	<b>115,231</b>	<b>83,506</b>

### 15 Zotimet dhe Kontingjentet

Zotimet

Nuk ka zotime me 31 Dhjetor 2016 përveç marrëveshjes së qerasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Pagesa mujore e qerasë për zyre dhe salla të trajnimeve është 2,800 Euro.

Çështjet gjyqësore

Me 31 Dhjetor 2016 nuk është llogaritur asnjë provision për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon risqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

### 16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonje ngjarje pas dates së raportimit që kërkon korrigjim ose shpallje në pasqyrat financiare.



15

VJET  
YEARS





## **ShKÇAK falenderon të gjithë pjesëmarrësit në forumin “Specializimi Profesional-Domosdoshmëri për Zhvillim Ekonomik”**


Për realizimin e këtij forumi të suksesshëm i falenderojmë panelistët për kontributin e tyre e të cilët kanë ofruar diskutime jo vetëm mbi problemet të cilat e përcjellin zhvillimin ekonomik por edhe mënyrën se si ata kanë kontribuar në këtë drejtim, ligjëruesit për kontributin në sesione paralele, sponsorët dhe mbështetësit tanë që kanë qenë tërë kohën pranë nesh si dhe bizneset të cilat kanë promovuar fushëveprimin e tyre në kuadër të këtij forumi.

Shoqata do të jetë aktive për promovimin e mbrojtjes së interesit publik dhe gjetjes së mënyrës më të mirë për implementimin e specializimeve profesionale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.

**Bizneset dhe Institucionet Edukative pjesëmarrëse në Panair:**



**Sponsorizuar nga:**




Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Cooperation Office Kosovo





Congress & Event Organization

**Mbështetur nga:**



 SCAAK / ShKÇAK

 SCAAK

 SCAAK / ShKÇAK

[www.scaak.org](http://www.scaak.org)